



**MBËSHTETJA E QEVERIVE PËR PËRMIRËSIMIN
E EFIÇIENCËS ENERGJETIKE SI NJË PËRGJIGJE
NDAJ ZBUTJES SË GODITJEVE (TË ARDHSHME)
ENERGJETIKE: GJASHTËSHJA E BALLKANIT
PERËNDIMOR**

MBËSHTETJA E QEVERIVE PËR PËRMIRËSIMIN E EFIÇIENCËS ENERGJETIKE SI NJË PËRGJIGJE NDAJ ZBUTJES SË GODITJEVE (TË ARDHSHME) ENERGJETIKE: GJASHTËSHJA E BALLKANIT PERËNDIMOR

Ky publikim është bërë me përkrahjen e projektit rajonal "SMART Balkans - Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor" që zbatohet nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetëm zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë apo të partnerëve të konsorciumit SMART Balkans.

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE NË SEKTORIN E ENERGJISË TË BALLKANIT PERËNDIMOR	8
2. KRIZA ENERGJETIKE NË BP6, MJETET QË PËRDOREN PËR T'IA DALË MBANË KRIZËS	12
2.1 NDIKIMI I KRIZËS ENERGJETIKE NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR	14
2.1.1 Shqipëria	14
2.1.2 Bosnja dhe Hercegovina	16
2.1.3 Kosova	16
2.1.4 Mali i Zi	18
2.1.5 Maqedonia e Veriut	19
2.1.6 Serbia	20
3. VËSHTRIM HISTORIK I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR (2010-2020)	22
3.1 POLITIKAT DHE PROGRAMET E IMPLEMENTUARA PËR TË PËRMIRËSUAR EE NË BP6	25
3.1.1 Shqipëria	25
3.1.2 Bosnja dhe Hercegovina	27
3.1.3 Kosova	28
3.1.4 Mali i Zi	29
3.1.5 Maqedonia e Veriut	30
3.1.6 Serbia	32
4. PIKËPAMJA PËR TË ARDHMEN- ARRITJA E OBJEKTIVAVE TË EE PËR VITIN 2030, PROMOVIMI I PUNËSIMIT DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK NË BP6.	35
4.1 HYRJE	35
4.2 SHQIPËRIA	37
4.3 BOSNJA DHE HERCEGOVINA	40
4.4 KOSOVA	41
4.5 MALI I ZI	44
4.6 MAQEDONIA E VERIUT	46
4.7 SERBIA	48
4.8 MUNDËSITË E PUNËSIMIT PËR TË RRIUR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM EKONOMIK	51
PËRFUNDIM	55
REKOMANDIME	56

FIGURAT

Figura 1- Kapaciteti i instaluar në BP6 sipas burimit (MWh) për vitin 2022.	9
Figura 2- Intensiteti energjetik në BP6 (KGOE për mijë EUR) në 2020	10
Figura 3- Konsumi final i energjisë në Ballkanin Perëndimor (milion ton ekuivalent nafte)	11
Figura 4- Varësia nga importi (përqindje) e BP6 në 2022	13
Figura 5- Çmimet e energjisë elektrike për ekonomitë familjare - euro/MWh (pa tatime dhe taksa)	13
Figura 6- Konsumi i energjisë në Kosovë gjatë vitit.	14
Figura 7- Konsumi final i energjisë (mijë ton ekuivalent nafte) sipas sektorit në BP6 në 2021	24
Figura 8- Programet e eficiency së energjisë në BeH (mil/EUR) nga 2010 deri 2020	28
Figura 9- Programet e eficiency së energjisë në Kosovë (mil/EUR) nga 2010 deri 2020	29
Figura 10- Programet e eficiency së energjisë në Malin e Zi (mil/EUR) nga 2010 deri 2020	30
Figura 11- Programet e eficiency së energjisë në Maqedoninë e Veriut (mil/EUR) nga 2010 deri 2020	32
Figura 12- Programet e eficiency së energjisë në Serbi (mil/EUR) nga 2010 deri 2020	34
Figura 13- Intensiteti energjetik i Shqipërisë	37
Figura 14- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Shqipëri për të arritur objektivat e përcaktuara për EE	39
Figura 15- Kostoja e energjisë së kursyer në Shqipëri sikur të importohet në EUR	39
Figura 16- Intensiteti energjetik në BeH	40
Figura 17- Kostoja e energjisë së kursyer në BeH sikur të importohet në EUR.	41
Figura 18- Intensiteti energjetik i Kosovës	42
Figura 19- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Kosovë për të arritur objektivat e përcaktuara për EE.	43
Figura 20- Kostoja e energjisë së kursyer në Kosovë sikur të importohet në EUR.	44
Figura 21- Intensiteti energjetik i Malit të Zi	44
Figura 22- Kostoja e energjisë së kursyer në Malin e Zi sikur të importohet në EUR.	45
Figura 23- Intensiteti energjetik i Maqedonisë së Veriut	46
Figura 24- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Maqedoninë e Veriut për të arritur objektivat e përcaktuara për EE.	47
Figura 25- Kostoja e energjisë së kursyer në Maqedoninë e Veriut sikur të importohet në EUR	48
Figura 26- Intensiteti energjetik i Serbisë	48
Figura 27- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Serbi për të arritur objektivat e përcaktuara për EE.	50
Figura 28- Kostoja e energjisë së kursyer në Serbi sikur të importohet në EUR.	50
Figura 29- Vende pune të krijuara nga investimet në EE- sektori rezidencial (2021-2031).	52
Figura 30- Vende pune të krijuara nga investimet në EE- sektori komercial (2021-2031).	52
Figura 31- Vende pune të krijuara nga investimet në EE- sektori industrial (2021-2031).	53
Figura 32- Vende pune afatgjata të krijuara nga investimi në EE (2031-2051)	54

TABELAT

Tabela 1-Skenarët e synuar për EE në Shqipëri	38
Tabela 2- Skenarët e synuar për eficiency të energjisë në Kosovë	43
Tabela 3- Skenarët e synuar për eficiency të energjisë në Maqedoninë e Veriut	47
Tabela 4- Skenarët e synuar për eficiency të energjisë në Serbi	49

SHKURTESAT

BE	Bashkimi Evropian
BeH	Bosnja dhe Hercegovina
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BP6	Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor- Kosova, Serbia, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi.
BPV	Bruto Produkti Vendor
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CO2	Dioksidi i karbonit
EE	Efiçienca e energjisë
EnC	Komuniteti i Energjisë
EPCG	Kompania Kombëtare Energjetike e Malit të Zi
EPS	Korporata Energjetike e Serbisë
EUR	Euro
GEFF	Instrumenti i Financimit të Ekonomisë së Gjellbër
GIZ	Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim
GWh	Gigavat orë
HUPX	Bursa Hungareze e Energjisë Kompani e Kufizuar me Aksione
IFN	Institucion Financiar Ndërkombëtar
IPA	Instrumenti i Asistencës Para-aderimit
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike
KESCO	Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut i Republikës së Kosovës
Ktoe	Kiloton ekuivalent nafte
kWh	Kilovat orë
LEEPRE	Ligji për efiçencën e energjisë dhe përdorimin racional të energjisë
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
Mtoe	Megaton ekuivalent nafte
MWh	Megavat orë
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PKEK	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
toe	Ton ekuivalent nafte
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

PËRMBLEDHJE

EKZEKUTIVE

Rajoni i Ballkanit Perëndimor karakterizohet nga nivele të larta të thëngjillit dhe intensitetit energjetik, duke tejkaluar trefish mesataren e BE-së. Lulatjet e fundit në tregun e energjisë kanë përkeqësuar sfidat, duke ndikuar veçanërisht në popullatën e cenueshme përmes rritjes së çmimeve të energjisë elektrike dhe varfërisë së energjisë. Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë dhe stabilizimit të çmimeve të energjisë elektrike pas arritjes së kulmit në vitin 2022, shumë sfida ngulmojnë, duke ndikuar në sigurinë energjetike të rajonit.

Implementimi i masave të efijencës së energjisë është jetik jo vetëm për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, por edhe për nxitjen e zhvillimit ekonomik, për stabilitetin dhe pavarësinë energjetike. Rritja vjetore e kërkesës për energji dhe intensiteti i lartë energjetik, tre herë më i madh se mesatarja e BE-së, e bëjnë investimin në efijencën e energjisë sektor me prioritet për vendet e BP6. Kriza e fundit energjetike ka treguar më tej cenueshmërinë e sistemit, ku më shumë se 500 milionë euro (afërsisht gjysma e investimit të bërë në BP6 gjatë dhjetë viteve të fundit) u nevojitën për të kompensuar ndikimin e krizës dhe përfundimisht çmimi i energjisë elektrike u rrit mesatarisht 10 për qind për konsumatorët fundorë në mbarë BP6.

Nga pikëpamja e politikave, vendet e BP6 kanë përafuar politikat e tyre me pakon e tretë të energjisë. Megjithatë, sfidat vazhdojnë në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, veçanërisht në sektorin e ndërtimit, ku kërkohen investime të konsiderueshme renovimi. Pavarësisht mbështetjes ndërkombëtare, nevojat për investime mbeten të paplotësuara, me vetëm 30 për qind të fondeve të nevojshme të alokuara ndërmjet 2010 dhe 2020. Megjithatë, energjia e kursyer nga investimet e bëra gjatë kësaj periudhe është ekuivalente me qindra miliona euro. Investimet e qeverisë në EE janë drejtuar në masë të madhe drejt ndërtesave publike me më shumë se 771.1 milionë të investuara në sektorin publik krahasuar me 288.8 milionë euro në sektorin rezidencial/komercial.

Për sa i përket investimeve, Bosnja dhe Hercegovina (BeH) ka investuar 253 milionë euro, me 22 për qind në sektorin rezidencial përmes Bankave dhe Fondit të Gjellbër për Rritje. Kosova ka investuar 48.8 milionë euro në sektorin publik dhe 130 milionë euro në sektorin rezidencial përmes iniciativave të ndryshme. Mali i Zi ka alokuar 85 milionë euro për EE në ndërtesat publike dhe përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, me vetëm katër projekte të implementuara përmes bankave komerciale. Maqedonia e Veriut ka investuar 40 milionë euro në sektorin rezidencial përmes kredive të ashtuquajtura të buta dhe projekteve të financuara nga donatorët dhe 120 milionë euro në sektorin publik. Serbia ka implementuar projekte në shumën totale prej 415 milionë euro, me rreth 95 milionë euro të investuara në sektorin rezidencial.

Në drejtim të objektivave për vitin 2030, EE shfaqet si politikë vendimtare dhe e pagabueshme për zhvillimin e qëndrueshëm në rajonin e BP6. Ndërsa progresi është

i dukshëm, ka hendek të theksuar në investime prej rreth 2.4 miliardë euro gjatë dekadës së ardhshme. Arritja e këtyre objektivave parashikohet të rezultojë në reduktim të konsiderueshëm të kërkesës për energji, kursime buxhetore dhe mundësi të krijimit të vendeve të punës, duke sjellë përfitim si për ekonominë ashtu edhe për komunitetet lokale. Me nxitjen e krijimit të rreth 40,000 vendeve të reja të punës (4,073 në Kosovë, 6,250 në Serbi, 7,450 në Shqipëri, 5,819 në BeH, 2,091 në Maqedoninë e Veriut, 5,558 në Malin e Zi dhe 10,000 vende pune afatgjata indirekte në të gjashtë vendet) dhe kursime të energjisë prej më shumë se 1 miliard euro për 10 vitet e ardhshme, EE shndërrohet në alternativë të politikës të pa gabueshme.

Megjithatë, sfidat ngulmojnë, duke përfshirë kufizimet buxhetore dhe nevojën për të fuqizuar sektorin privat për angazhim aktiv në iniciativat për EE. Për të trajtuar këtë aspekt, nevojitet theks më i madh në ndërtimin e kapaciteteve të sektorit privat dhe lehtësimin e mekanizmave të financimit. Kjo përfshin mbështetjen e institucioneve financiare, zhvillimin e llojllojshmërisë së ofertave për huadhënie të ngjashme me ato që ofrohen në Kosovë dhe BeH, krijimin e fondeve të garancisë dhe ofrimin e granteve/subvencioneve. Për më tepër, përgatitja e një fuqie punëtore të aftë është thelbësore për të garantuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të EE, ku për implementimin e skemave nevojiten mbi 30 mijë punëtorë.




1. HYRJE NË SEKTORIN E ENERGJISË TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Sektori i energjisë i Ballkanit Perëndimor, rajon në Evropën Juglindore që përfshin Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, luan rol vendimtar në zhvillimin ekonomik dhe sigurinë energjetike të rajonit. Historikisht, rajoni është mbështetur shumë në lëndët djegëse fosile konvencionale si thëngjilli për të përmbushur kërkesat e veta për energji. Megjithatë, vitet e fundit, ka pasur zhvendosje në rritje drejt diversifikimit të miksit të energjisë, përmirësimit të efikasitetit të energjisë dhe integritit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Ballkani Perëndimor paraqet peizazh kompleks energjetik të karakterizuar nga miksi i kompanive shtetërore, përpjekjet e privatizimit dhe projektet e vazhdueshme për zhvillimin e infrastrukturës. Sfida të tilla si infrastruktura e vjetruar, prodhimi joeficient i energjisë dhe shqetësimet mjedisore kanë nxitur përpjekje për të modernizuar dhe reformuar sektorin. Furnizimi me energji në rajon është tepër i varur nga thëngjilli, ndërsa energjia e ripërtëritshme dominohet nga prodhimi në hidrocentrale. Të gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (BP6) mbështeten në burimet e brendshme të thëngjillit për një përqindje të madhe të energjisë së tyre totale, me përjashtim të Shqipërisë, e cila mbështetet kryesisht në hidrocentralet. Sipas Figurës 1, duke përjashtuar importet e energjisë, në vitin 2022, thëngjilli ishte burimi mbizotërues i energjisë elektrike të prodhuar në vendet e BP6, ku kapaciteti i instaluar përbën më shumë se 46 për qind të totalit, me përmasa të ndryshme që variojnë nga 48 për qind në BeH, 21 për qind në Mal të Zi, 49 për qind në Maqedoninë e Veriut, 89 për qind në Kosovë dhe 53 për qind në Serbi. Megjithatë, gazi natyror luan rol dukshëm më të vogël në miksin e konsumit primar të energjisë në BP6 krahasuar me Bashkimin Evropian (BE). Ky dallim i atribuohet kryesisht mungesës së tregut të gazit natyror në Kosovë dhe Mal të Zi, dhe lidhjen e Shqipërisë në vitet e fundit me tubacionin ndërkombëtar të gazit natyror përmes Gazsjellësit Trans-Adriatik.¹

¹ OECD. Tranzicioni i Energjisë së Pastër në Ballkanin Perëndimor. Burimi: <https://t4.oecd.org/south-east-europe/programme/OECD-BN-Clean-Energy-Transition-Oct2022.pdf> (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

Figura 1- Kapaciteti i instaluar në BP6 sipas burimit (MWh) për vitin 2022.



Burimi: Eurostat

Bashkimi Evropian (BE) është angazhuar në mënyrë aktive në mbështetjen e tranzicionit të energjisë në Ballkanin Perëndimor përmes iniciativave të tilla si Traktati i Komunitetit të Energjisë, i cili synon të integrojë rajonin në tregun energjetik të BE-së si dhe të promovojë praktikën e qëndrueshme të energjisë². Përveç kësaj, Instrumenti i BE-së për Asistencën e Para-Aderimit (IPA) ofron mbështetje financiare dhe teknike për projektet e infrastrukturës energjetike dhe reformat rregullatore³.

Burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke përfshirë energjinë nga ujërat, era, dielli dhe biomasa, po njihen gjithnjë e më shumë si shtytësit kryesorë të tranzicionit energjetik të rajonit. Investimet në projekte të energjisë së ripërtëritshme janë në rritje, të mbështetura nga korniza të favorshme rregullatore, stimuj dhe partneritete me palë të interesuara ndërkombëtare⁴.

Pavarësisht progresit, sektori i energjisë në Ballkanin Perëndimor përballet me sfida të vazhdueshme, duke përfshirë kompleksitetin politik dhe rregullator, kufizimet financiare dhe nevojën për rritje të transparencës dhe stabilitet në qeverisje. Adresimi i këtyre sfidave do të jetë thelbësor për zhblokimin e potencialit energjetik të rajonit, rritjen e sigurisë energjetike dhe mbështetjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Sipas figurës 1, energjia e ripërtëritshme përbën një përqindje relativisht të madhe të miksit energjetik të BP6 në 2022, me kapacitet të instaluar që varion nga 10 për qind në Kosovë, 37 për qind në Maqedoninë e Veriut, 41 për qind në Serbi, 52 për qind në BeH, 78 për qind në Mal të Zi deri në 100 për qind në Shqipëri. Megjithatë, pjesa më e madhe e kësaj energjie u prodhuan nga përdorimi i hidro-gjeneratorëve, një burim energjie i kamotshëm në rajonin e BP6, pavarësisht nga potenciali i konsiderueshëm

2 Komuniteti i Energjisë. Traktati themelues i Komunitetit të Energjisë. Burimi: <https://www.energy-community.org/legal/treaty.html> (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

3 Komisioni Evropian. Instrumenti i Asistencës Para-aderimit. Burimi: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en (Qasja e fundit më: 4 shkurt 2024)


4 Komuniteti i Energjisë. Gjurmuesi i Tranzicionit të Energjisë në BP6. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:c7db8188-0b04-443b-9f41-728ee182fc90/EnC_WB6_ETT3_062021.pdf (Qasja e fundit më: 30 janar 2024)

për gjenerimin e energjisë nga era dhe dielli. Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme nga burimet jo-hidrike është ende në fazat e hershme të zhvillimit, ku kapacitetet nga dielli/era përbëjnë vetëm 5 për qind të kapacitetit të instaluar.

Në vitin 2020, konsumi final i energjisë në BP6 ishte mesatarisht 3096 mijë tonë ekuivalent naftë (toe). Ndryshe nga Bashkimi Evropian, ku konsumi i energjisë ka shënuar trend rënës viteve të fundit, konsumi në BP6 ka shënuar rritje të lehtë gjatë dekadës së fundit, me mesatare prej 2985 mijë toe në 2011⁵. Për më tepër, në vitin 2020, të gjitha ekonomitë e BP6 kishin intensitet më të lartë energjetik në BPV sesa BE-ja, duke i bërë industritë e tyre më të cenueshme nga rritja e çmimeve të energjisë⁶.

Rajoni përjeton intensitet të lartë energjetik për shkak të disa faktorëve: tarifa të ulta të energjisë elektrike, si rezultat i prodhimit nga linjiti dhe hidrocentralet, infrastruktura e amortizuar e energjisë, zhvillimi i kufizuar ekonomik dhe ritmi i ngadaltë i investimeve në masat e efijencës së energjisë. Me intensitetin më të lartë energjetik në Kosovë (467.24 KGOE për mijë EUR), ndjekur nga afër nga Bosnja dhe Hercegovina (458.96 KGOE për mijë EUR) dhe Serbia (425.18 KGOE për mijë EUR) krahasuar me mesataren evropiane prej 116.33 KGOE për mijë EUR,⁷ ky intensitet energjetik është dëshmi që veprimet institucionale janë fokusuar në anën e ofertës në vend se në anën e kërkesës për energji.

Figura 2- Intensiteti energjetik në BP6 (KGOE për mijë EUR) në 2020



Burimi: Eurostat


5 OECD. Tranzicioni i Energjisë së Pastër në Ballkanin Perëndimor. Burimi: <https://t4.oecd.org/south-east-europe/programme/OECD-BN-Clean-Energy-Transition-Oct2022.pdf> (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

6 Eurostat. Intensiteti energjetik. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/nrg_ind_ei/default/table?lang=en (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

7 Po aty

Sipas figurës 3, konsumi final i energjisë në BP6 është rritur gradualisht, kjo kërkesë e shtuar për energji mund t'i atribuohet zhvillimit gradual ekonomik të rajonit, zgjerimit të tregut, urbanizimit dhe mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. Me rritje mesatare vjetore të konsumit final të energjisë prej 2.7⁸ për qind dhe investime të pamjaftueshme në infrastrukturën energjetike, efiçencën e energjisë dhe zgjerimin e tregut, vendet e Ballkanit Perëndimor janë gjithnjë e më të cenueshme nga krizat energjetike. Kjo qëndron veçanërisht kur shikohen modelet e përsëritura të konsumit, ku mungesa e diversitetit të burimeve energjetike dhe jofleksibiliteti i sistemit energjetik, i lë tregjet e energjisë në BP6 të cenueshme nga tronditjet energjetike të tregut gjatë muajve të pikut në dimër.

Figura 3- Konsumi final i energjisë në Ballkanin Perëndimor (milion ton ekuivalent nafte)



Burimi: Eurostat

8 Eurostat, Konsumi final i energjisë sipas sektorit. Burimi: <https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/ten00124/default/table?lang=en> (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

2. KRIZA ENERGETIKE NË BP6, MJETET QË PËRDOREN PËR T'IA DALË MBANË KRIZËS

Në gjysmën e dytë të vitit 2021 dhe duke vazhduar në vitin 2023, çmimet e energjisë në Evropë u rritën në nivele të paprecedenta, të nxitura nga kombinimi i faktorëve afatshkurtër dhe afatgjatë që shkaktuan luhatje si në kërkesë ashtu edhe në ofertë. Ndër këta faktorë përfshihen rritja e kërkesës globale për gaz natyror ndërsa ekonomitë rimëkëmben nga pandemia, rezervat e pamjaftueshme të gazit dhe rritja e çmimeve që ndërlikohet me lejimet e emetimeve brenda BE-së⁹. Kohët e fundit, agresioni i vazhdueshëm në shkallë të gjerë i Rusisë në Ukrainë dhe sanksionet ndërkombëtare që rrjedhimisht u vendosën ndaj Rusisë, prodhuese dhe eksportuese e rëndësishme e naftës dhe gazit natyror, kanë çrregulluar tregjet globale të energjisë dhe kanë pasur ndikim në çmimet e energjisë me pakicë.

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor shfaqin shkallë të ndryshme të cenueshmërisë nga luhatjet e çmimeve të energjisë, por në përgjithësi, furnizimi i tyre me energji mbetet relativisht i paprekur. Pavarësisht varësisë së madhe nga Rusia si furnizues i vetëm i gazit, roli i gazit natyror në portofolat energjetikë të rajonit është modest. Rrjedhimisht, vendet e BP6 nuk janë shumë të cenueshme nga çrregullimet e theksuara në furnizimin me energji, edhe në skenarë ku importet e gazit nga Rusia janë të kufizuara ose mungojnë. Megjithatë, gjatë dekadës së fundit, Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë përjetuar varësi në rritje nga importet e gazit rus, që përbën afërsisht 12.5 për qind dhe 10.7 për qind të miksit të tyre total të energjisë në vitin 2020¹⁰.

Rajoni përballet me cenueshmëri nga ndryshimet në çmimin e naftës së papërpunuar dhe produkteve të naftës, kryesisht për shkak të përdorimit të tyre të gjerë në transport dhe prodhimin të kufizuar rajonal. Megjithatë, pavarësisht nga kjo varësi, kontributi i Rusisë në importet totale të naftës dhe produkteve të naftës në rajon mbeti modest, duke përbërë vetëm 3 për qind nga 2018 në 2020. Në gusht 2022, Eurozona përjetoj rritje të mprehtë të inflacionit energjetik, duke arritur në 38.3 për qind¹¹.


Megjithatë, shumica e ekonomive të BP6 janë shumë të ekspozuara ndaj rritjes së kostos së importeve të energjisë, veçanërisht të energjisë elektrike. Shumica e rajonit mbështetet shumë në energjinë elektrike të importuar, me varësinë nga importi që varion nga 23 për qind në Shqipëri deri në 68 për qind në Maqedoninë e Veriut, sipas figurës 4.

9 OECD. Tranzicioni i Energjisë së Pastër në Ballkanin Perëndimor.

10 Burimi: <https://t4.oecd.org/south-east-europe/programme/OECD-BN-Clean-Energy-Transition-Oct2022.pdf> (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

11 Po aty


Figura 4- Varësia nga importi (përqindje) e BP6 në 2022



Burimi: Eurostat

Varësia nga tregjet rajonale të energjisë dhe luhatja e çmimeve gjatë krizës energjetike të viteve 2021-2022, solli rritje graduale të çmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë. Siç tregon figura 5, rritja më e lartë me 12.29 u shënuar në Maqedoninë e Veriut që i atribuohet varësisë së saj nga importi i energjisë elektrike.

Figura 5- Çmimet e energjisë elektrike për ekonomitë familjare - euro/MWh (pa tatime dhe taksa)




Burimi: Eurostat

Siç tregon figura 6, Kosova, për shkak të përdorimit të përhapur të ngrohjes jo-eficiente me energji elektrike dhe kërkesës së lartë gjatë muajve të dimrit, është e detyruar të importojë edhe sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike në muajt tetor-prill. Trende të ngjashme ndjekin të gjitha vendet e tjera të rajonit¹².

¹² FMN. Sfidat dhe mundësitë e sektorit të energjisë elektrike të Kosovës. Burimi: <https://www.imf.org/-/media/Files/Publications/Selected-Issues-Papers/2023/English/SIPEA2023025.ashx> (Qasja e fundit më: 24 shkurt 2024)

Figura 6- Konsumi i energjisë në Kosovë gjatë vitit.



Burimi: Eurostat

Për më tepër, kushtet e pafavorshme të motit dhe aksidentet në termocentralet në Serbi bënë të nevojshme importe të mëdha të energjisë elektrike në fund të 2021 dhe në fillim të 2022¹³.

Për më tepër, sektorët industrialë në BP6 cenohen dukshëm nga rritja e çmimeve të energjisë, veçanërisht ato ekonomi që kanë industri me intensitet të lartë energjetik si prodhimi i çelikut, aluminit ose plehrave, ku për shkak të krizës energjetike, shumë kompani u detyruan të mbyllnin përkohësisht ose përgjithmonë veprimtarinë e tyre.

2.1 NDIKIMI I KRIZËS ENERGJETIKE NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

2.1.1 Shqipëria

Me popullsi prej rreth 2.85 milionë banorë, Shqipëria varet kryesisht nga hidrocentralet për prodhimin e energjisë elektrike. Ndërsa kjo varësi ofron përfitim për sa i përket emetimeve të karbonit në industrinë e energjisë elektrike, ajo gjithashtu e lë vendin shumë të cënueshëm nga ndryshimet klimatike. Luhatjet e konsiderueshme në prodhimin e energjisë hidrike nënkuptojnë se pavarësisht shtimit të impianteve të shumta prodhuese të energjisë vitet e fundit, Shqipëria shpesh e gjen veten duke kërkuar importe të energjisë elektrike¹⁴.

¹³ Banka Botërore. Shënime të politikave, Serbia. Burimi: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099405505042315889/pdf/IDU042c6815203699044e709b4206703e04a8259.pdf> (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

¹⁴ Rrjeti Bankwatch. Sektori i energjisë në Shqipëri. Burimi: <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/energy-sector-in-albania> (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

Në Shqipëri, segmenti i tregut përgjegjës për furnizimin universal përfiton nga detyrimi i shërbimit publik që ka prodhuesi shtetëror i energjisë përmes hidrocentraleve, KESH. Çmimet brenda këtij segmenti përcaktohen nga kostot e prodhimit se sa të ndikohen drejtpërdrejt nga çmimet e tregut global ose rajonal, duke i bërë ato të cenueshme kryesisht nga kushtet e motit. Megjithatë, duke qenë se prodhimi vetëm nga KESH nuk mund të plotësojë tërësinë e kërkesës brenda segmentit të ofertës universale, furnizuesi universal duhet të sigurojë një pjesë të portofolit të tij nga tregu, shpesh përmes importit¹⁵. Kjo e ekspozon furnizuesin universal ndaj rreziqeve të luhatjes së çmimeve dhe mungesës së mundshme të të hyrave.

Nga ana tjetër, konsumatorët industrialë dhe konsumatorët e tjerë që operojnë brenda tregut të lirë i nënshtrohen blerjes së energjisë elektrike me çmimet e tregut rajonal. Rrjedhimisht, çdo rritje e ndjeshme e çmimeve ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e tyre.

Në tetor 2021, Qeveria Shqiptare shpalli gjendjen e jashtëzakonshme deri në prill 2022¹⁶. Pas kësaj, u mor vendimi për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik gjatë gjendjes së emergjencës, duke urdhëruar që e gjithë energjia elektrike e prodhuar nga KESH t'i alokohej furnizuesit universal. Sipas këtij akti, çdo tepriçë e krijuar nga KESH duhej të magazinohet nëpërmjet një marrëveshjeje tregtare dhe të përdorej nga furnizuesi universal. Gjithashtu, Qeveria ndau 100 milionë euro në vitin 2021, për të lehtësuar importin e energjisë elektrike me çmime të larta. 100 milionë euro të tjera u ndanë për tremujorin e parë të 2022¹⁷.

Gjithashtu, në përputhje me vendimin e Qeverisë, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes u udhëzuan të rishikojnë planet e tyre për investime dhe të shtyjnë çdo investim jo-urgjent.

Ndërkohë që qeveria ka ndërhyrë me dy pako financiare për të ulur ndikimin e çmimeve rajonale, tarifatat e energjisë elektrike janë rishikuar dhe rritur lehtë si për konsumatorët rezidencialë ashtu edhe për ata komercialë¹⁸.

15 Enti Rregullator i Energjisë. Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2020. Burimi: <https://ere.gov.al/doc/Raporti%20Vjetor%202020.pdf> (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

16 Alice Taylor. Shqipëria shpall gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike mes krizës energjetike. Burimi: https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/albania-declares-state-of-energy-emergency-amid-energy-crisis/. (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

17 English News. Shqipëria prezanton një sërë masash për të përballuar rritjen e çmimeve. Burimi: <https://english.news.cn/europe/20220313/b698057911cd49b5aa6058688cbf91f6/c.html> (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

18 Enti Rregullator i Energjisë. Raport Vjetor. Burimi: <https://www.ere.gov.al/images/2022/04/Raporti%20Vjetor%202021%20perfundimtare.pdf> (Qasja e fundit më: 3 shkurt 2024)

2.1.2 Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina, vend me popullsi prej rreth 3.5 milionë banorë, aktualisht qëndron si eksportuesi i vetëm neto i energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kapaciteti i këtij vendi për prodhimin e energjisë elektrike është kryesisht me burim nga hidrocentralet, duke përbërë mbi gjysmën e kapacitetit gjithsej, ndërsa pjesa e mbetur vjen nga pesë termocentrale me linjit¹⁹.

Në vitin 2022, vendi zotëronte kapacitet neto të instaluar hidroenergjetik që kalonte 10 MW, në total rreth 2076 MW, krahas 2065 MW të kapacitetit të linjtit. Për më tepër, burimet e energjisë në shkallë më të vogël përfshinin 182 MW energji nga hidrocentralet të vogla, 135 MW nga energjia e erës, 102 MW nga energjia diellore dhe 93 MW nga prodhimi industrial i energjisë²⁰. Shpërndarja e prodhimit të energjisë elektrike zakonisht anon drejt dy të tretave nga thëngjilli dhe një të tretës nga hidrocentralet, në varësi nga kushtet mbizotëruese hidrologjike.

Gjatë kësaj periudhe të rritjes së çmimeve, prodhuesit e energjisë elektrike në Bosnjë e Hercegovinë kanë realizuar të hyrat më të larta të shënuara ndonjëherë, pasi rritja e çmimeve rajonale përkthehet në eksporte me çmime më të larta nga kompanitë prodhuese boshnjake. Për më tepër, këto kompani kanë përfituar nga mungesa e çmimit të karbonit për energjinë elektrike të prodhuar nga lëndët djegëse fosile, duke e bërë atë më konkurruese në tregjet fqinje të BE-së.

Tregu me pakicë i energjisë elektrike në Bosnjë dhe Hercegovinë mbështetet kryesisht në energjinë elektrike nga burimet e brendshme të rezervuara për furnizim me pakicë. Akterët kryesorë në këtë treg janë kompanitë e integruara vertikalisht që ngërthejnë funksionet e prodhimit, furnizimit dhe tregtisë. Prandaj, ndikimi i krizës energjetike u ndie në masë më të vogël në Bosnjë sesa në vendet e tjera të rajonit.

2.1.3 Kosova

Kosova, me popullsi prej përafërsisht 1.7 milionë banorë, mbështetet shumë në prodhimin e energjisë elektrike nga dy termocentrale të vjetruara të linjtit: Kosova A, që ka pesë njësi me kapacitet të instaluar të kombinuar prej 800 MW, dhe Kosova B, e përbërë nga dy njësi me kapacitet total të instaluar prej 678 MW. Aktualisht, kapaciteti i këtyre centraleve është afërsisht 915 MW së bashku. Termocentralet janë të njohura për kontributin e tyre të ndjeshëm në ndotjen e ajrit, ku Kosova B është ndër emetuesit më të mëdhenj të pluhurit në mesin e të gjitha termocentraleve të thëngjillit në Ballkanin Perëndimor.²¹

Vendi në përgjithësi operon si importues neto i energjisë elektrike, me trend veçanërisht 19 Rrjeti Bankwatch. Sektori i energjisë në Bosnjë e Hercegovinë. Burimi: <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/the-energy-sector-in-bosnia-and-herzegovina> (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

20 Bosnja dhe Hercegovina - Autoriteti Shtetëror Rregullator i Energjisë Elektrike. Raporte mbi veprimtarinë e Autoritetit Shtetëror Rregullator të Energjisë Elektrike. Burimi: <https://www.der.k.ba/DocumentsPDFs/BIH-SERC-Annual-Report-2022.pdf> (Qasja e fundit më: 2 shkurt 2024)

21 Rrjeti Bankwatch. Sektori i energjisë në Kosovë. Burimi: <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/the-energy-sector-in-kosovo> (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

isht të dukshëm gjatë periudhave të dimrit kur kërkesa është më e lartë, duke rezultuar në çmime të larta. Aktualisht, Kosova importon energji elektrike përmes të gjitha interkoneksioneve të saj, përveç me Serbinë, ku Operatori i Sistemit të Transmetimit të këtij vendi fqinj e ka vendosur kapacitetin neto të transmetimit në zero²².

Pjesa më e madhe e furnizimit të shërbimit universal plotësohet nga prodhimi i brendshëm me çmime relativisht të ulëta, të plotësuar nga importet e energjisë elektrike gjatë orëve të pikut dhe veçanërisht në mot të ftohtë. Pas rishikimit të rregullt të tarifave të kryer nga rregullatori, furnizuesi i shërbimit universal kërkoi rishikim të jashtëzakonshëm të tarifave për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë me shumicë.

Nga kriza energjetike, janë prekur edhe operatorët e rrjetit, të cilët blejnë energji elektrike nga tregu për të mbuluar humbjet e rrjetit. Kjo situatë posaçërisht ndikon në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, KOSTT, pasi furnizimi në pjesën veriore të vendit bëhet përmes humbjeve në rrjetin e transmetimit.

Autoriteti rregullator kombëtar, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), ka përfunduar rishikimin e tarifave për segmentin e rregulluar, i cili përfshin Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal. Në këtë rishikim, ZRRE ngriti supozimin për çmimin e importit në 90€/MWh dhe ndau fonde shtesë prej 5 milionë euro për shërbimin universal si masë për rastet e paparashikueshme të rritjes së mëtejshme të kostos së energjisë elektrike²³. ZRRE pranoi të gjitha kostot aktuale të energjisë elektrike për palët deri në qershor 2021, duke rregulluar gjithashtu çmimet mesatare të importit të energjisë për pjesën e mbetur të vitit 2021.

Për më tepër, Ministria e Ekonomisë ka iniciuar një grup ad-hoc që përbëhet nga palët kryesore të interesuara, të udhëhequr nga rregullatori, për të vlerësuar ndikimin e rritjes së çmimeve dhe për të propozuar masa mbështetëse të mundshme, krahas përpjekjeve të vazhdueshme për të promovuar kursimet e energjisë përmes një fushate të përgjithshme. Prandaj, vetëm në dhjetor 2021, KEDS dhe KESCO kanë importuar energji elektrike në vlerë prej 32.3 milionë euro²⁴. Qeveria ka subvencionuar një shumë prej 120 milionë euro për sektorin e energjisë, të cilat u janë shpërndarë drejtpërdrejt konsumatorëve përmes zbritjeve në faturat e tyre përfundimtare të energjisë elektrike dhe subvencioneve të importit²⁵.

22 Di Bella e të tjerë. Sfidat dhe mundësitë e sektorit të energjisë elektrike të Kosovës. Burimi: <https://www.elibrary.imf.org/view/journals/018/2023/025/article-A001-en.xml>. (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

23 Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti Vjetor 2021. Burimi: <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportetpercent20Vjetor/Annualpercent20Reportpercent202021.pdf> (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

24 Po aty

25 Instituti GAP. Përfitimet ekonomike nga investimet në efizienzë të energjisë në Kosovë. Burimi: [https://www.institutigap.org/documents/75476_eficiencia_energjiise_SHQ_\(draft4\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/75476_eficiencia_energjiise_SHQ_(draft4).pdf) (Qasja e fundit më: 25 janar 2024)

2.1.4 Mali i Zi

Me popullsi prej rreth 621.000 banorësh, Mali i Zi kryesisht mbështetet në ndërmarrjen shtetërore të shërbimeve publike Elektroprivreda Crne Gore (EPCG) për të përmbushur nevojat e veta për energji elektrike. EPCG operon termocentralin e linjtit 225 MW në Pljevlje, krahas hidrocentraleve 307 MW Perućica dhe 342 MW Piva²⁶.

Deri në vitin 2009, Mali i Zi importonte shumë energji elektrike, import ky i shtyur kryesisht nga kërkesa e fabrikës së aluminit KAP, e cila dikur konsumonte deri në 40 për qind të energjisë elektrike në vend. Megjithatë, kriza e vazhdueshme në operacionet e fabrikës ka çuar në pasiguri në lidhje me të ardhmen e saj. Megjithëse kërkesa e fabrikës është ulur që nga viti 2011, duke arritur 17 për qind të konsumit të energjisë elektrike të vendit në vitin 2020, ajo pushoi së funksionuari plotësisht në 2023 pas kallimit në operim minimal në dhjetor 2021²⁷.

Aftësia e Malit të Zi për të përmbushur kërkesën e vet për energji elektrike brenda vendit është luhatur që nga viti 2010, varësisht nga kushtet hidrologjike. Vitet me shi si 2010, 2013 dhe 2018 mundësuan plotësimin e kërkesës së brendshme, ndërsa vitet e thata si 2011, 2012 dhe 2017 ngrenë nevojën për importe të konsiderueshme të energjisë elektrike²⁸.

Megjithatë, bazuar në të dhënat e energjisë nga viti 2021, prodhimi dhe konsumi i brendshëm i Malit të Zi pothuajse ishin të barabartë.

Çmimet e energjisë elektrike për konsum familjar dhe të vogël kanë mbetur të pandryshuara që nga viti 2019, siç parashikon shprehimisht Ligji për Energjinë. Ky legjislacion ofron mbrojtje specifike për ekonomitë familjare dhe konsumatorët e vegjël komercialë. Kjo mbrojtje është ofruar për shkak të konkurrencës së kufizuar në tregun e shitjes me pakicë, duke siguruar që rritjet e mundshme të çmimeve të energjisë elektrike për këto kategori konsumatore të kufizohen në 6 për qind.

Ndërsa çmimet e larta të energjisë në tregun me shumicë nuk kanë ndikuar ende në çmimet e shitjes me pakicë për ekonomitë familjare dhe konsumatorët e vegjël komercialë, ato kanë ndikuar tek OST dhe OSSH. Ky ndikim rrjedh nga rritja e papritur e çmimeve të energjisë që është e nevojshme për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Kriza energjetike preku kompaninë shtetërore, duke rezultuar në humbje prej më shumë se 60 milionë euro gjatë vitit 2022²⁹. Rritja e kostove të shkaktuara për blerjet e energjisë për të mbuluar këto humbje parashikohet të ndikojë në tarifatat për përdorimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes në periudhën e ardhshme rregullatore prej 2023 deri në 2025³⁰.

26 Rrjeti Bankwatch. Sektori i energjisë në Malin e Zi. Burimi: <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/the-energy-sector-in-montenegro> (Qasja e fundit më: 26 janar 2024)

27 Agjencia Rregullatore e Energjisë dhe Shërbime Komunale e Malit të Zi. Raporti i Sektorit të Energjisë. Burimi: https://regagen.co.me/wp-content/uploads/2022/12/20221229_ENERGY-SECTOR-REPORT-MONTENEGRO-2021.pdf (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

28 Rrjeti Bankwatch. Sektori i energjisë në Malin e Zi. Burimi: <https://bankwatch.org/beyond-fossil-fuels/the-energy-sector-in-montenegro> (Qasja e fundit më: 26 janar 2024)

29 Instituti Kinë-EQL. Kriza energjetike dhe përgjigja e vendeve të EQL – Studim i rastit të Malit të Zi. <https://china-cee.eu/2022/11/09/montenegro-social-briefing-energy-crisis-and-cee-countries-response-montenegro-study/> (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

30 Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe Shërbimeve Komunale e Malit të Zi. Raporti

Deri më tani, nuk ka pasur rritje të theksuar të disbalancave ndërmjet palëve përgjegjëse balancuese. Megjithatë, metodologjia për përcaktimin e çmimeve, afateve dhe kushteve për ofrimin e shërbimeve ndihmëse dhe balancuese për OST-në i lidh çmimet me çmimet e tregut të një dite më parë (indeksi HUPX). Rrjedhimisht, vendimi për rritje për periudhën nga viti 2023 deri në vitin 2025 ka hyrë në fuqi që nga janari i vitit 2024³¹.

Përveç disa masave të marra për eficientë e energjisë, qeveria ende nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me krizën energjetike dhe përgatitjen për tronditjet e ardhshme energjetike.

2.1.5 Maqedonia e Veriut

Maqedonia e Veriut, vend pa dalje në det me popullsi prej rreth 2 milionë banorësh, kryesisht varet nga burimet e energjisë nga lëndët djegëse fosile si linjiti me cilësi të ulët dhe gazi, si dhe nga hidrocentralet, dhe mbështetet shumë në importet e energjisë elektrike. Në vitin 2022, krahas 1,471 GWh të importuara, vendi prodhoi gjithsej 5,634 GWh energji elektrike për të përmbushur kërkesën e përgjithshme të brendshme për energji elektrike³².

Vitet e fundit, vendi ka përjetuar rënie graduale të prodhimit të energjisë elektrike, kryesisht për shkak të faktorëve që kontribuojnë në situatë rënduar energjetike. Zvogëlimi i rezervave dhe rënia e cilësisë së linjtit kanë dalë si sfida të theksuara për sektorin energjetik të vendit. Gjithashtu, luhatjet e kushteve hidrologjike kanë ndikuar në performancën e kapaciteteve hidroelektrike, duke ndikuar më tej në prodhimin e energjisë elektrike.

Si rezultat i këtyre sfidave, Maqedonia e Veriut është mbështetur gjithnjë e më shumë në importet e energjisë elektrike për të përmbushur nevojat e veta të konsumit të brendshëm. Në vitin 2020, importet përbënin 32 për qind të konsumit të brendshëm bruto të vendit, ndërsa kjo shifër u rrit në 37 për qind në vitin 2021³³. Kjo varësi e shtuar nga importet nënvizon cënueshmërinë e sektorit energjetik të vendit ndaj faktorëve të jashtëm dhe thekson rëndësinë e implementimit të masave për të rritur prodhimin e brendshëm të energjisë dhe rimëkëmbshmërinë energjetike.

Konsumatorët e vegjël komerciale dhe ekonomitë familjare luajnë rol vendimtar në peizazhin e energjisë, duke përfituar nga shërbimi universal i ofruar nga një kompani private. Kjo siguron furnizim të besueshëm me energji elektrike për këta sektorë thelbësorë të ekonomisë. Megjithatë, korniza rregullatore për çmimet e energjisë dhe dinamika e furnizimit është subjekt i përshtatjeve dhe konsideratave të vazhdueshme, duke reflektuar nevojat dhe sfidat e zhvillimeve brenda sektorit.

i Sektorit të Energjisë në Malin e Zi 2021. Burimi: https://regagen.co.me/wp-content/uploads/2022/12/20221229_ENERGY-SECTOR-REPORT-MONTENEGRO-2021.pdf (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

31 SeeNews. Mali i Zi rrit çmimin e energjisë elektrike me 5,6 për qind nga 1 janari - raport. Burimi: <https://seenews.com/news/montenegro-to-hike-electricity-prices-by-5-6-percent-from-jan-1-report-1239857> (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

32 Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Raporti Vjetor 2022. Burimi: https://www.erc.org.mk/odluki/2023.04.26_RKE%20GI%202022-FINAL%20ALB.pdf (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

Për më tepër, mbështetja e furnizuesit universal në prodhuesin më të madh vendas të energjisë elektrike, që është ent shtetëror, nënvizon ndërlidhjen e palëve të ndryshme të interesuara brenda tregut të energjisë. Siç përcaktohet me Ligjin për Energjinë, varësia e furnizuesit universal nga prodhuesi shtetëror zvogëlohet gradualisht me kalimin e kohës, duke reflektuar përpjekjet për të diversifikuar burimet e energjisë dhe për të zbutur risqet që lidhen me mbështetjen e tepërt në një furnizues të vetëm³⁴.

Për më tepër, si komponent kritik i sektorit të energjisë, tregu balancues ka pësuar ndikime të theksuara nga rritja e çmimit të energjisë elektrike me shumicë. Çmimet balancuese luajnë rol vendimtar në ruajtjen e stabilitetit të rrjetit dhe sigurimin e shpërndarjes eficiente të energjisë. Megjithatë, disbalancat ndërmjet çmimeve të tregut dhe çmimeve balancuese kanë çuar në sfida operationale, duke përfshirë përdorimin e të gjithë kapacitetit balancues të disponueshëm hidrik brenda afateve të shkurtra kohore³⁵.

Në nëntor të vitit 2021, Qeveria e Maqedonisë së Veriut shpalli gjendjen e jashtëzakonshme një mujore në sektorin energjetik dhe më pas i ofroi ndihmë financiare prodhuesit primar, ESM SH.A., dhe operatorit të sistemit të transmetimit, MEPSO. Gjatë vitit 2022, qeveria ndau rreth 222.7 milionë euro për të zbutur efektin e krizës energjetike,³⁶ krahas rritjes prej 12.29 për qind të çmimit të energjisë elektrike në krahasim me çmimet e vitit 2021³⁷.

2.1.6 Serbia

Serbia, me popullsi prej rreth 6.9 milionë banorësh, kryesisht i plotëson nevojat e veta për energji elektrike përmes burimeve të brendshme. Vendi mbështetet shumë në thëngjillin e linjitet me cilësi të ulët për rreth 70 për qind të prodhimit të energjisë elektrike në vend, duke çuar në shqetësime të konsiderueshme për ndotjen. Hidrocentralet kontribuojnë në pjesën më të madhe të gjenerimit që mbetet. Pavarësisht përparimeve të dukshme në energjinë e erës, e cila ka shënuar rritje të fortë vitet e fundit, ajo përbënte vetëm 2.8 për qind të totalit të energjisë elektrike të prodhuar në 2021³⁸.

Në çmimet e tregut të një dite më parë në Serbi, të menaxhuara nga SEEPEX, mirëmbahet një korrelacion i rëndësishëm me trendet rajonale të çmimeve. Rritja e mundshme e çmimeve për konsumatorët industrialë dhe komercialë është e pritshme, veçanërisht në rastet kur kontratat e furnizimit janë afër skadimit.

³⁴ Po aty

³⁵ Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:bbb63b32-6446-4df8-adc6-c90613daf309/Draft_NECP_NM_percent202020.pdf (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

³⁶ Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Kovaçevski: Askush nuk do të lihet vetëm në kushte të krizës, masat kundër krizës kanë efekt. Burimi: <https://vlada.mk/node/31146?ln=sq> (Qasja e fundit më: 12 mars 2024)

³⁷ Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Raporti Vjetor 2022. Burimi: https://www.erc.org.mk/odluki/2023.04.26_RKE%20GI%202022-FINAL%20ALB.pdf (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

³⁸ Eurostat. Përqindja e energjisë së ripërtëritshme në konsumin final bruto të energjisë sipas sektorit. Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/sdg_07_40/default/table?lang=en&category=t_nrg.t_nrg_sdg_07 (Qasja e fundit më: 4 shkurt 2024)

Për të mbrojtur konsumatorët e ndikuar drejtpërdrejt, qeveria serbe ka marrë masa të tilla si ngrirja e çmimeve specifike në tregun e hapur, lehtësuar nga EPS, që është kompania shtetërore e prodhimit dhe furnizimit. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka rishikuar gjithashtu protokollat e veta për rritjen e sigurisë financiare që kërkohet nga palët përgjegjëse balancuese për të zbutur rreziqet që lidhen me ekspozimin më të lartë në tregun balancues.

Sipas rekomandimit të Qeverisë, EPS ka pranuar që çmimi për konsumatorët e furnizimit komercial nga data 1 maj 2023 të jetë 110.81 EUR/MWh. Për më tepër, çmimi i furnizimit të instancës së fundit u rrit nga 67 në 97 EUR/MWh, me adoptimin e konkluzionit në lidhje me furnizimin e instancës së fundit duke rekomanduar që EPS të mundësojë furnizimin e instancës së fundit për konsumatorët fundorë të energjisë elektrike që nuk gëzojnë të drejtën për furnizim të garantuar pas datës 1 janar 2022, me çmimin 97.50 EUR/MWh pa TVSH, më parë 66.72 EUR/MWh³⁹.

Në sektorin e gazit, çmimi i importit për gazin ose çmimi i gazit të prodhuar në Serbi është përcaktuar me Dekret të Qeverisë në nivelin e nëntorit 2019, ku çdo mbingarkesë çmimi për prokurimin e gazit rikuperohet nga Qeveria që nga dhjetori 2021. Pas Dekretit fillestar, u bënë disa ndryshime që rritën gradualisht çmimin e përcaktuar të shitjes me shumicë të gazit.

Në nëntor 2023, Serbia lidhi marrëveshje me Azerbajxhanin për të blerë 400 milionë metra kub gaz natyror në vit duke filluar nga viti 2024. Serbia ka parashikuar prej kohësh blerjen e gazit nga Azerbajxhani pas përfundimit të interkonektorit në tubacionin e Bullgarisë⁴⁰.

³⁹ Agjencia Rregullatore e Republikës së Serbisë. Ndikimi i çmimeve të larta të energjisë në nivel kombëtar. Burimi https://erranet.org/wp-content/uploads/2022/04/High_Energy_Prices_ERRA_roundtable_by_members_CPWG_Apr2022.pdf. (Qasja e fundit më: 4 shkurt 2024)

⁴⁰ Reuters. Serbia nënshkruan marrëveshjen e furnizimit me gaz me Azerbajxhanin.

Burimi: <https://www.reuters.com/business/energy/serbia-signs-gas-supply-deal-with-azerbaijan-2023-11-15/>. (Qasja e fundit më: 4 shkurt 2024)

3. VËSHTRIM HISTORIK I EFIÇIENCËS SË ENERGJISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR (2010-2020)

Në Deklaratën e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, të rënë dakord në nëntor 2020, të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor u zotuan për objektiva ambicioze mjedisore dhe klimatike, të strukturuar përgjatë pesë shtyllave:

- klima, energjia dhe transporti.
- ekonomia qarkore.
- ulja e ndotjes.
- bujqësia e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit; dhe
- ruajtja e biodiversitetit.

Në përputhje me Marrëveshjen e Parisit, vendet e BP6 kanë rënë dakord të arrijnë neutralitetin e klimës deri në vitin 2050, duke ulur emetimet e gazeve serrë me 55 për qind deri në vitin 2030. Në këtë drejtim, qeveritë e BP6 janë zotuar për realizimin e tranzicionit drejt të energjisë së pastër⁴¹.

Për të siguruar progres të koordinuar dhe të qëndrueshëm, rajoni është zotuar të përmirësojë qeverisjen ndër-sektoriale, duke integruar objektivat e tranzicionit të gjelbër dhe me karbon të ulët në administratën publike, menaxhimin financiar dhe programet e reformës ekonomike. Për më tepër, vendet e BP6 synojnë të forcojnë kapacitetet administrative për të implementuar Agjendën e Gjelbër, duke siguruar respektimin e detyrimeve mjedisore, duke nxitur pjesëmarrjen e publikut dhe duke rritur mekanizmat e raportimit mjedisor. Angazhimi aktiv në rrjetet pan-evropiane, skemën Horizon 2020, organizatat rajonale, strategjitë makro-rajonale dhe iniciativat si Pakti i Kryetarëve të Komunave/Bashkive është gjithashtu prioritet.

41 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Burimi: <https://www.rcc.int/download/docs/Leaderspercent20Declarationpercent20onpercent20thepercent20Greenpercent20Agendapercent20forpercent20thepercent20WB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf> (Qasja e fundit më: 9 shkurt 2024)

Nga ana tjetër, BE-ja ka hartuar një sërë strategjish për të lehtësuar këtë tranzicion brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor. Këto përfshijnë përafrimin me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë për të çuar përpara përpjekjet për dekarbonizimin në sektorin e energjisë dhe zhvillimin e Planeve Kombëtare të Energjisë dhe Klimës të përshtatura enkas për secilin vend. Gjithashtu, si rrjedhim i detyrimeve të marra në Komunitetin e Energjisë, do të nisen programe për trajtimin e skemave publike dhe private të renovimit të ndërtesave, me fokus në sigurimin e financimit të duhur, frymëzuar nga “vala e renovimit e BE-së” që u tregua e suksesshme dhe u shtri në Ballkanin Perëndimor⁴².

Konsumi i energjisë me efikasitet është thelbësor për konsumatorët rezidencialë në ekonominë e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht pasi sektori rezidencial përbën 34 për qind, i ndjekur nga sektori i industrisë me 22 për qind të konsumit total⁴³ (Figura 7). Pamundësia për të përballuar çmimet më të larta të energjisë dhe luhatja e konsumit gjatë ndryshimeve stimore përbën sfidë të theksuar, ku Maqedonia e Veriut raportoï përqindjen më të lartë të ekonomive familjare në Evropë që nuk ishin në gjendje të ngroheshin siç duhet shtëpitë e tyre në vitin 2019⁴⁴. Kjo nënvizon nevojën e ngutshme për masa efektive për të trajtuar çështjet e përballueshmërisë dhe qasjes në energji në nivel rajoni. Megjithatë, sfidat ekzistuese, si mbështetja në lëndët djegëse fosile, adoptimi i kufizuar i energjisë së ripërtëritshme dhe degradimi i mjedisit, nënvizojnë urgjencën për implementimin e masave gjithëpërfshirëse të efikasitetit të energjisë. Programet e financuara nga qeveria që synojnë zëvendësimin e sistemeve të vjetruara të ngrohjes janë të kufizuara, ku programet e para po implementohen përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë buxhetore nga BE për shkak të krizës energjetike që BP6 po përballon⁴⁵.

Përqindja e madhe e konsumit të energjisë në sektorin e ekonomive familjare dhe industrisë, tregon gjithashtu mundësi për të përmirësuar intensitetin energjetik të rajonit, duke stimuluar sektorin privat për të investuar në masa EE.


42 Komuniteti i Energjisë. Shtrirja e valës së renovimit në Ballkanin Perëndimor: Propozim për rritjen e efikasitetit të energjisë në sektorin e ndërtesave rezidenciale. Burimi: <https://www.energy-community.org/dam/jcr:d533ab6e-5c1c-43e6-8c1c-dc03d72e8fa6/DP012021.pdf>. (Qasja e fundit më: 22 shkurt 2024)

43 Eurostat. Konsumi final i energjisë sipas sektorit. Burimi: <https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/ten00124/default/table?lang=en> (Qasja e fundit më: 7 shkurt 2024)

44 ComAct. Raport përmbledhës mbi konceptin e varfërisë energjetike. Burimi: https://www.bpie.eu/wp-content/uploads/2021/05/ComAct-D1.1_Overview-report-on-the-energy-poverty-concept_Final-version_UPDATED-1.pdf (Qasja e fundit më: 24 shkurt 2024)

45 Bashkimi Evropian. Pakoja e Mbështetjes Energjetike. Burimi: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/6fb6e0a6-fb15-49dd-80e5-dd0d9fbf4ebe_en. (Qasja e fundit më: 24 shkurt 2024)

Figura 7- Konsumi final i energjisë (mijë ton ekuivalent nafte) sipas sektorit në BP6 në 2021.



Burimi: Eurostat

Ndërsa përfitimet e efijencës së energjisë njihen mirë, duke përfshirë kthimin e shpejtë investimit, krijimin e mundësive të punësimit, përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve dhe reduktimin e pasigurisë gjatë tronditjeve të tregut, adopsioni i politikave dhe programeve që mbështesin efijencën e energjisë në Ballkanin Perëndimor ka qenë i ngadalshëm. Pavarësisht avantazheve të dukshme, mbetet një hendek në implementimin e masave efektive për të promovuar efijencën e energjisë në rajon. Seksioni i mëposhtëm do të analizojë më tej politikën dhe programet që janë marrë për të përmirësuar efijencën e energjisë në BP6 gjatë periudhës 2010-2020, ndërsa seksioni 4 do të analizojë më tej përfitimet e arritjes së objektivave të EE për vitin 2030.

3.1 POLITIKAT DHE PROGRAMET E IMPLEMENTUARA PËR TË PËRMIRËSUAR EE NË BP6

Gjatë shqyrtimit të iniciativave për eficiencën e energjisë në të gjithë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, dalin disa aspekte të përbashkëta por dhe dallime, duke reflektuar qasjen unike të secilit vend dhe përparimin drejt arritjes së objektivave të eficiencës së energjisë. Gjatë dekadës së fundit (2010-2020) të gjitha vendet e BP6 kanë bërë përparim të dukshëm në përshtatjen e legjislacionit kombëtar sipas kërkesave të BE-së, duke përfshirë transpozimin e pakove të shumta të legjislacionit për energjinë. Ndërkohë, fare pak programe janë implementuar për të rritur eficiencën e energjisë.

Kur krahasojmë llojet e investimeve në eficiencën e energjisë ndërmjet sektorit publik dhe atij rezidencial në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, mund të vërejmë variacione në fokus dhe në alokimin e burimeve. Shumica e vendeve i kanë dhënë prioritet investimeve në sektorin publik, veçanërisht në ndërtesat publike, spitalet dhe strukturat institucionale, që përbëjnë më shumë se 70 për qind të totalit të investimeve. Kjo pasqyron qasje strategjike për përmirësimin e eficiencës së energjisë në asetet e zotëruara nga qeveria, duke synuar të jepet shembull dhe të udhëhiqet sipas shembëlltyrës. Investimet në sektorin publik shpesh përfshijnë bashkëpunime me partnerë ndërkombëtarë dhe institucione financiare, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore. Financimi për investimet e sektorit publik vjen kryesisht nga projektet e financuara nga donatorët, buxhetet e qeverisë dhe huat nga institucionet financiare ndërkombëtare. Kjo nxjerr në pah varësinë nga financimi i jashtëm për të mbështetur iniciativat për eficiencën e energjisë në ndërtesat dhe infrastrukturën publike.

Ndërsa investimet në sektorin rezidencial janë evidente, ato shpesh marrin më pak vëmendje në krahasim me sektorin publik. Po implementohen iniciativa të tilla si subvencionet, rimbursimet dhe kreditë e ashtuquajtura të buta për të nxitur praktika me eficiencë të energjisë në radhët e ekonomive familjare. Këto programe synojnë të kapërcejnë barrierat financiare dhe të inkurajojnë individët të investojnë në teknologjitë dhe lartësimet e nevojshme për kursimin e energjisë. Për më tepër, për zbatimin e projekteve të tilla ishte i nevojshëm financimi i jashtëm. Përveç mbështetjes financiare nga qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare, investimet në sektorin rezidencial mund të përfshijnë skema të bashkëfinancimit me konsumatorët. Kjo kërkon që pronarët e shtëpive të kontribuojnë një pjesë të kostos së investimit, duke demonstruar zotimin e tyre për përmirësimet e eficiencës së energjisë në pronat e tyre. Seksioni i mëposhtëm do të analizojë në hollësi investimet e bëra në secilin vend përgjatë periudhës 2010-2020.

3.1.1 Shqipëria

Shqipëria njihet domosdoshmërinë për të reduktuar varësinë nga importet e energjisë dhe tranzicionin drejt një sistemi të diversifikuar energjetik, duke vënë theksin te burimet alternative si gazin dhe burimet e ripërtëritshme për të ulur emetimet e gazeve serrë. Ky ndryshim është vendimtar për implementimin e masave me kosto efektive të eficiencës së energjisë, të cilat nga ana e tyre do të duhej të jenë instrumentale në

forcimin e prodhimit të brendshëm dhe sigurimin e përbalueshmërisë për konsumatorët, duke kontribuar kështu në uljen e varfërisë.

Strategjia Kombëtare e Energjisë e Shqipërisë përshkruan objektiva të qarta për të rritur sigurinë e energjisë duke diversifikuar prodhimin e energjisë elektrike, duke reduktuar humbjet teknike dhe jo-teknike në rrjetin e energjisë dhe duke rritur eficiencën e përgjithshme të energjisë⁴⁶. Strategjia i jep prioritet promovimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë përmes planifikimit me kosto më të ulët për të minimizuar importet e energjisë dhe për të përmirësuar intensitetin energjetik duke reduktuar emetimet e gazeve serrë. Dokumentet kryesore të politikave, duke përfshirë Ligjin për Eficiencën e Energjisë, ofrojnë kornizën për implementimin e masave të eficiencës së energjisë, me përpjekje të vazhdueshme për të rishikuar dhe zhvilluar akte nënligjore mbështetëse për të lehtësuar implementimin.

Veçanërisht, krijimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë dhe mekanizmave financues si Instrumenti për Financimin e Ekonomisë së Gjelbër (GEFF) i BERZH-it demonstronë zotimin e Shqipërisë për të promovuar eficiencën e energjisë si në sektorin rezidencial ashtu edhe në atë komercial⁴⁷ me linjë kreditore prej tre milionë eurosh për ProCredit Bank. Në vitin 2018, Bashkia e Tiranës ofroi një fond prej 565 mijë eurosh si stimul për qytetarët që duan të investojnë në eficiencën e energjisë. Bashkia subvencionoi një pjesë të investimit total⁴⁸. Gjithashtu, projekte pilot si ai në Bashkinë e Durrësit, të fokusuara në përmirësimin e eficiencës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, nënvizojnë qasjen proaktive të Shqipërisë në implementimin e nismave të kursimit të energjisë në sektorë të ndryshëm⁴⁹.

Ndërsa janë bërë pak përmirësime për të rritur eficiencën e energjisë në Shqipëri, vendi ishte më së largu në rajon nga arritja e objektivave të vendosura kombëtare dhe atyre të vendosura nga EnC për vitin 2020, duke arritur më pak se 60 për qind të objektivave të vendosura (si legjislative ashtu edhe jo- legjislative). Investimi total në Shqipëri gjatë periudhës 2010-2020 ishte 54 milionë euro në eficiencë të energjisë, ndërsa totali i investimit të nevojshëm për të arritur objektivat ambicioze të vendosura nga EnC ishte 388 milionë euro⁵⁰.

46 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Shqipërisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:a0c2b8a8-96c8-4423-993a-537cf51daa65/Draft_NECP_AL_percent202021.pdf (Qasja e fundit më: 27 janar 2024)

47 Agjencia për Eficiencë të Energjisë. Raporti i Pestë Vjetor sipas Direktivës së Eficiencës së Energjisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:432a1625-0935-46cf-84e6-6832aa0a1f03/AL_5thEED_AR_1221.pdf (Qasja e fundit më: 27 janar 2024)

48 Po aty

49 Agjencia për Eficiencë të Energjisë. Raporti i Katërt Vjetor sipas Direktivës së Eficiencës së Energjisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:49f48604-be82-449f-bef2-530c9e94ad94/4thEED_AR_AL_062020.pdf (Qasja e fundit më: 27 janar 2024)

50 Agjencia për Eficiencë të Energjisë. Raporti i Katërt Vjetor sipas Direktivës së Eficiencës së Energjisë https://www.energy-community.org/dam/jcr:2077a2ba-805a-4ca2-afcb-91c90ecc0878/EnC_WB6_ETT1_072020.pdf (Qasja e fundit më: 27 janar 2024)

3.1.2 Bosnja dhe Hercegovina

Në përputhje me detyrimet e Bosnjës dhe Hercegovinës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe direktivave përkatëse, duke përfshirë Direktivën 2006/32/KE për konsumin final të energjisë dhe shërbimet e efijencës së energjisë (ESD), Direktivën 2010/31/BE për efijencën e energjisë të ndërtesave (EPBD), dhe Direktivën 2012/27/BE për efijencën e energjisë (EED), Bosnja dhe Hercegovina ka zhvilluar dhe adoptuar një Plan Veprimi për Efijencën e Energjisë për periudhën 2016-2018⁵¹. Ky plan synon të nxisë përpjekje të planifikuara, sistematike dhe të pandërprera drejt përdorimit racional të energjisë dhe rritjes së efijencës në të gjithë sektorët. Për më tepër, BeH ka miratuar legjislacionin kryesor në lidhje me efijencën e energjisë dhe rregulloret përkatëse, duke përfshirë Ligjin për efijencën e energjisë të Federatës së Bosnjës e Hercegovinës, Ligjin për planifikimin hapësinor dhe përdorimin e tokës të Federatës së Bosnjës e Hercegovinës, Ligjin për energjinë elektrike të Federatës së Bosnjës e Hercegovinës, Ligjin për energjinë të Republikës Serbe. Ligji për efijencën e energjisë së Republikës Serbe, Ligji për planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e Republikës Serbe, Ligji për energjinë elektrike dhe Ligji për transportin rrugor të Republikës Serbe⁵².

Lidhur me masat jo-legjislative, BeH është i vetmi vend në BP6 që ka arritur të përbushë objektivin e efijencës së energjisë të vendosur nga EnC. Gjatë dekadës së shkuar, BeH ka implementuar aktivitete të shumta në rritjen e efijencës së energjisë në anën e ofertës dhe në masë më të vogël në anën e kërkesës. Mirëpo, pak programe janë implementuar për të mbështetur sektorin rezidencial në masat e efijencës së energjisë dhe modernizimin apo renovimin e ndërtesave publike. Ndërsa objektivi është arritur, vetëm 253 milionë nga 783 milionë të parashikuara janë investuar⁵³, nga të cilat, siç tregon figura 8, rreth 78 për qind janë investime në ndërtesa publike dhe investime në efijencë të energjisë në transmetim/shpërndarje dhe 22 për qind investime në sektorin rezidencial. Për më tepër, shumica e këtyre investimeve në sektorët rezidencialë/komercialë bëhen përmes programeve financiare të realizuara nga institucione financiare si BERZH, KfW, Fondi i Gjelbër për Rritje, etj⁵⁴.


51 Ministry of Foreign Trade and Economic Relations of Bosnia and Herzegovina. 5th Annual Report under the Energy Efficiency Directive. Source: https://www.energy-community.org/dam/jcr:816a7cad-e70a-4808-9e6a-9ffb1afbcfaa/BiH_5thEED_AR_11202.pdf (Last accessed on Jan 29, 2024)

52 Government of Bosnia and Herzegovina. Bosnia and Herzegovina Integrated Energy and Climate Plan. Source: https://www.energy-community.org/dam/jcr:fffa65bf-d137-454d-aad7-992eee783af6/NECPpercent20BiHpercent20v.7_ENG.pdf (Last accessed on Jan 29, 2024)

53 Energy Community. WB6 Energy Transition Tracker. Source: https://www.energy-community.org/dam/jcr:2077a2ba-805a-4ca2-afcb-91c90ecc0878/EnC_WB6_ETT1_072020.pdf (Last accessed on Jan 29, 2024)

54 Energy Community. 5th Annual Report under the Energy Efficiency Directive. Source: https://www.energy-community.org/dam/jcr:816a7cad-e70a-4808-9e6a-9ffb1afbcfaa/BiH_5thEED_AR_11202.pdf (Last accessed on February 18, 2024)

Figura 8- Programet e efijencës së energjisë në BeH (mil/EUR) nga 2010 deri 2020.



Source: Energy Community (BiH Yearly EE Report)

3.1.3 Kosova

Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në trajtimin e sfidave të sektorit të energjisë dhe përmbushjen e obligimeve të saj sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Progres i dukshëm është arritur në efijencën e energjisë përmes miratimit të politikave dhe rregulloreve kryesore, duke përfshirë adoptimin e disa ligjeve si Ligji për energjinë, Ligji për energjinë elektrike, Ligji për efijencën e energjisë, Ligji për performancën energjetike në ndërtesa dhe Ligji për energjinë termike⁵⁵. Përveç masave legjislative, Kosova ka ndërmarrë hapa proaktivë duke përgatitur një projekt-version të Planit të Veprimit të Pestë Kombëtar për Efijencën e Energjisë (PVKEE) 2022-2024 në fillim të vitit 2023. Për më tepër, vendi ka formuluar një Strategji të Energjisë dhe ka hartuar Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), duke demonstruar zotimin për avancimin e nismave të efijencës së energjisë⁵⁶.


Gjithashtu, gjatë dekadës së fundit, janë realizuar projekte të ndryshme të udhëhequra nga qeveria në fushën e efijencës së energjisë. Megjithatë, këto iniciativa synonin kryesisht sektorin publik dhe ndriçimin publik, me fokus të kufizuar në sektorët rezidencialë dhe industrialë. Siç tregohet në figurën 9, gjatë gjithë kësaj periudhe, këto projekte kanë lehtësuar kursimin e energjisë në vlerën 8.01 ktoe (kiloton ekuivalent nafte) në sektorin publik, duke kërkuar investim prej 48.8 milionë euro. Në sektorin rezidencial dhe privat/komercial, u realizuan kursime energjie prej 21.6 ktoe, të mbështetura nga investimet në vlerën prej gjithsej 130 milionë euro, të cilat u mundësuan përmes iniciativave të tilla si projekti i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), bashkëfinancimi i konsumatorëve dhe qasja në kredi të gjelbra të ofruara nga bankat komerciale dhe BERZH⁵⁷.

55 Qeveria e Kosovës. Plani Kombëtar i Republikës së Kosovës për Energjinë dhe Klimën 2025-2030. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:e6badfbc-313d-4ebc-a450-416dcdbd5499/20230714_Finalpercent20Version_Firstpercent20Draftpercent20NECPpercent202025-2030percent20ofpercent20Kosovo.pdf (Qasja e fundit më: 25 janar 2024)

56 Po aty

57 Instituti GAP. Përfitimet ekonomike nga investimet në efijencë të energjisë në Kosovë. Burimi: [https://www.institutigap.org/documents/75476_eficienca_energjiise_SHQ_\(draft4\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/75476_eficienca_energjiise_SHQ_(draft4).pdf) (Qasja e fundit më: 25 janar 2024)

Figura 9- Programet e efijencës së energjisë në Kosovë (mil/EUR) nga 2010 deri 2020.



Burimi: Komuniteti i Energjisë (Raporti Vjetor për EE në Kosovë) dhe Qeveria e Kosovës (Ministria e Ekonomisë)

Për më tepër, gjatë vitit të shkuar, Kosova ka nisur disa projekte që synojnë efijencën e energjisë në sektorin rezidencial duke përfshirë sistemet e ngrohjes dhe pajisjet shtëpiake me EE, ngrohjen diellore të ujit dhe masat EE në sektorin rezidencial përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë buxhetore nga BE (40 nga 75 milionë euro)⁵⁸.

Ndërsa gjatë dhjetë viteve të fundit në Kosovë janë implementuar shumë projekte, vendi ka arritur të përmbushë vetëm 83 për qind të objektivave për EE (legjislative dhe jo-legjislative) duke implementuar projekte në shumën totale prej 178 milionë euro krahasuar me shumën e nevojshme për arritjen e caktuar prej 328 milionë euro⁵⁹.

3.1.4 Mali i Zi

Është shënuar progres në krijimin e kornizës legjislative dhe rregullatore për efijencën e energjisë përmes adoptimit të Ligjit për përdorimin eficient të energjisë dhe akteve nënligjore shoqëruuese përkatëse. Po ashtu, janë implementuar ndërhyrje përmes ndryshimit të ligjeve të caktuara, siç janë Ligji për planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e strukturave, Ligji për koncesionet, Ligji për prokurimin publik dhe Ligji për inspektimin e tregut. Zhvillimi i rregulloreve në lidhje me efijencën e energjisë në ndërtesa është i rëndësishëm së veçantë⁶⁰. Zbatimi detyrues i këtyre rregulloreve pritet të sjellë kursime të konsiderueshme të energjisë në të ardhmen, së bashku me përfitime të tjera të ndryshme, duke përfshirë uljen e kërkesës për energji, ndikimin pozitiv mjedisor, komoditetin e shtuar, nxitjen e ndërmarrësisë dhe futjen e materialeve dhe teknologjive të reja.


⁵⁸ Po aty

⁵⁹ Komuniteti i Energjisë. Gjurmuesi i Tranzicionit të Energjisë në BP6. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:2077a2ba-805a-4ca2-afcb-91c90ecc0878/EnC_WB6_ETT1_072020.pdf (Qasja e fundit më 29 janar 2024)

⁶⁰ Ministria e Investimeve Kapitale. Raporti i Pestë Vjetor sipas Direktivës së Efijencës së Energjisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:cc9b983d-94e2-45d5-92eb-a982187aa14b/5AR_EED_ME_062021.pdf (Qasja e fundit më: 25 janar 2024)

Për më tepër, janë krijuar rregullore shtesë, duke përfshirë rregulloren për etiketimin e energjisë dhe eko-dizajnin për pajisje të tilla si furrat, pllakat e gatimit/pianurat, dhe aspiratorët.⁶¹ Në planin jo-legjislativ, Mali i Zi ka bërë hapa përpara në implementimin e masave për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike, duke përfshirë spitalet dhe strukturat institucionale. Gjatë dekadës së fundit, Mali i Zi ka bashkëpunuar me partnerë ndërkombëtarë dhe institucione financiare për të investuar rreth 120 milionë në promovimin e efikasitetit të energjisë.⁶² Në përgjithësi, Mali i Zi ka arritur rreth 75 për qind të objektivit të tij sipas EnC. Mirëpo, shumica e këtyre masave janë implementuar përmes projekteve të financuara nga donatorët/qeveria për përmirësimin e EE në ndërtesat publike (85 milionë euro- figura 10) dhe përmirësimin e EE në rrjetin e furnizimit/shpërndarjes, me vetëm katër projekte që janë implementuar përmes bankave komerciale (financuar nga qeveria) dhe promovimin e programit të ngrohjes me EE në vlerë prej 4 milionë euro.⁶³

Figura 10- Programet e efikasitetit të energjisë në Malin e Zi (mil/EUR) nga 2010 deri 2020.



Burimi: Komuniteti i Energjisë (Raporti Vjetor për EE në Malin e Zi)

3.1.5 Maqedonia e Veriut

Në fushën e efikasitetit të energjisë, Maqedonia e Veriut është zotuar për të maksimizuar kursimet si në konsumin primar të energjisë ashtu edhe në atë final. Projektionet e bazuara në politikat aktuale tregojnë rritje të parashikuar prej 38 për qind të konsumit primar të energjisë dhe 55 për qind të konsumit final të energjisë deri në vitin 2040 krahasuar me nivelet e vitit 2017, të nxitur nga rritja e vazhdueshme ekono-

61 Ministria e Ekonomisë. Plani i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë në Malin e Zi për periudhën 2019-2021. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:c1fa6e92-54fe-467a-9c08-53cd3fad957d/4thNEEAP_MO_201907.pdf (Qasja e fundit më: 28 janar 2024)

62 Komuniteti i Energjisë. Gjurmuesi i Tranzicionit të Energjisë në BP6. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:2077a2ba-805a-4ca2-afcb-91c90ecc0878/EnC_WB6_ETT1_072020.pdf (Qasja e fundit më 29 janar 2024)

63 Komuniteti i Energjisë. Raporti i Pestë Vjetor sipas Direktivës së Efikasitetit të Energjisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:cc9b983d-94e2-45d5-92eb-a982187aa14b/5AR_EED_ME_062021.pdf (Qasja e fundit më 18 shkurt 2024)

mike⁶⁴. Duke pasur parasysh disponueshmërinë e kufizuar të linjitet dhe biomasës, si burime kryesore energjetike të brendshme të vendit, Maqedonia e Veriut vë theks të veçantë në efikasitetin e energjisë⁶⁵. Për të arritur këtë, do të implementohen një sërë politikash dhe masash nga 2020 deri 2040, duke synuar uljen e konsumit të energjisë në ndërtesa (përfshirë strukturat shtëpiake, komerciale dhe publike), sektorin industrial dhe në sektorin e transportit, si dhe minimizimin e humbjeve në rrjetet e transpormimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë.

Pavarësisht mungesës së legjislacionit dytësor që do të duhej të përvijojë objektivat dhe udhërrëfyesit për efikasitetin e energjisë, siç parashikohet me Ligjin e ri për efikasitetin e energjisë, Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (PKEK) përvijon paraprakisht kursimet që mund të arrihen pasi të hyjnë në fuqi kërkesat legjislative. Maqedonia e Veriut i jep përparësi parimit të dhënies prioritetit efikasitetit të energjisë në kuadër të PKEK-së së vet⁶⁶.

Ligji për efikasitetin e energjisë, i cili ngërthen direktivat për efikasitetin e energjisë dhe performancën e ndërtesave, u miratua në shkurt 2020. Ministria e Ekonomisë ka iniciuar përpilimin e akteve nënligjore në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Asistenca teknike nga GIZ ka mbështetur përgatitjen e Planit të Katërt të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë. Gjithashtu, është adoptuar Strategjia për Zhvillimin Energjetik deri në vitin 2040, e cila përfshin një pjesë të dedikuar për efikasitetin e energjisë⁶⁷.

Për sa i përket iniciativave praktike, janë nisur programe të ndryshme për të nxitur praktikatat me efikasitet të energjisë në ekonomi familjare. Për shembull, janë dhënë subvencione dhe kthime të fondeve të shpenzuara për blerjen dhe instalimin e sistemeve të kolektorëve termikë diellorë, dritareve nga PVC ose alumini, dhe kaldajave me pelet. Këto programe u lehtësuan me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit⁶⁸.

Për më tepër, projektet e financuara nga organizata ndërkombëtare, si Banka Evropiane e Investimeve, synojnë të promovojnë efikasitetin e energjisë në sektorin rezidencial. Këto nisma përfshijnë studime fizibiliteti, asistencë teknike dhe mbështetje financiare për projekte me efikasitet energjie. Fokusi shtrihet te burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe masat për të reduktuar ndotjen e ajrit, veçanërisht në zonat urbane shumë të ndotura. Për më tepër, projektet që synojnë efikasitetin e energjisë në ndërtesat dhe infrastrukturën publike janë në zhvillim e sipër, me mbështetje nga partneritete rajonale dhe ndërkombëtare⁶⁹.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:bbb63b32-6446-4df8-adc6-c90613daf309/Draft_NECP_NM_percent202020.pdf. (Qasja e fundit më 18 shkurt 2024)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:70ecdc38-453f-4f5c-ac4e-6e2c13eb557a/4NEEAPpercent20finalpercent20adopted_EN.pdf (Qasja e fundit më: 29 janar 2024)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:bbb63b32-6446-4df8-adc6-c90613daf309/Draft_NECP_NM_percent202020.pdf (Qasja e fundit më 18 shkurt 2024)


67 Po aty

68 Ministria e Ekonomisë - Republika e Maqedonisë së Veriut. Raporti i Pestë Vjetor sipas Direktivës së Efikasitetit të Energjisë Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:6b8b8684-9030-4334-bc13-ae5b631e8528/5thEED_AnnualReport_072021_NM.pdf (Qasja e fundit më: 2 shkurt 2024)

69 Po aty

Në përgjithësi, Maqedonia e Veriut ka arritur rreth 75 për qind të objektivit të saj sipas EnC, me investimin total të përbashkët (qeveria, sektori privat, partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit dhe institucionet financiare ndërkombëtare) prej 160 milionë euro⁷⁰. Siç tregon figura 11, rreth 40 milionë euro janë investuar në sektorin rezidencial përmes kredive të ashtuquajtura të buta, projekteve të financuara nga donatorët dhe projekteve të financuara nga qeveria dhe të tjerët në sektorin publik si ndriçimi publik, renovimi i ndërtesave qeveritare dhe qendrave arsimore/shëndetësore⁷¹.

Figura 11- Programet e efijencës së energjisë në Maqedoninë e Veriut (mil/EUR) nga 2010 deri 2020.



Source: Energy Community (North Macedonia Yearly EE Report)

3.1.6 Serbia

Ngritja e efijencës së energjisë në prioritet kryesor nënvizon domosdoshmërinë e miratimit të politikave dhe masave që ofrojnë zgjidhjet më efektive nga aspekti ekonomik dhe shoqëror në të gjithë sektorët. Projektionet tregojnë se deri në vitin 2030, konsumi final i energjisë nuk do të kalojë 9.6 Mtoe, me konsumin primar të energjisë të kufizuar në 14.68 Mtoe⁷². Përfitimet e rritjes së efijencës së energjisë janë të shumëfishta, duke përfshirë reduktimet e emetimeve të gazeve serrë, kostot e energjisë dhe përmirësimet në komoditetin e ndërtesave, së bashku me rritjen e vlerës së shtuar, punësimit dhe konkurrueshmërisë së biznesit, duke kontribuar përfundimisht në uljen e varfërisë. Hyrja në fuqi e Ligjit për efijencën e energjisë dhe përdorimin racional të energjisë (LEEPRE) në vitin 2021, duke zëvendësuar legjislacionin e mëparshëm, paraqet hap

70 Komuniteti i Energjisë. Gjurmuesi i Tranzicionit të Energjisë në BP6. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:2077a2ba-805a-4ca2-afcb-91c90ecc0878/EnC_WB6_ETT1_072020.pdf (Qasja e fundit më 29 janar 2024)

71 Ministria e Ekonomisë - Republika e Maqedonisë së Veriut. Raporti i Pestë Vjetor sipas Direktivës së Efijencës së Energjisë Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:6b8b8684-9030-4334-bc13-ae5b631e8528/5thEED_AnnualReport_072021_NM.pdf (Qasja e fundit më: 2 shkurt 2024)

72 Qeveria e Republikës së Serbisë. Plani i Integruar Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Serbisë për periudhën deri në 2030 me projeksione deri në 2050. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:01992fc5-4981-4ee3-84f8-f1f96830b4ba/INECP_Serbia_ENG_13.06.23percent20.pdf (Qasja e fundit më: 3 shkurt 2024)

bosht në këtë drejtim⁷³. LEEPRE shërben si kornizë gjithëpërfshirëse legjislative, duke vendosur terma dhe kushte për përdorimin e energjisë me efikasitet, menaxhimin e energjisë dhe masa të ndryshme në nivel të politikave. Për më tepër, ai vendos bazat për financimin e iniciativave të efikasitetit të energjisë përmes krijimit të Drejtorisë për Financimin dhe Promovimin e Efikasitetit të Energjisë dhe përcakton kushtet për kontraktimin e shërbimeve të energjisë. LEEPRE është harmonizuar në masë të konsiderueshme me Direktivën e Efikasitetit të Energjisë 2012/27/BE dhe rregulloret e tjera përkatëse të BE-së, duke siguruar pajtueshmërinë dhe duke lehtësuar adoptimin e objektivave të efikasitetit të energjisë përtej vitit 2021 dhe duke mundësuar vendosjen e kërkesave të eko-dizajnit⁷⁴. Veçanërisht, ligji mundëson implementimin e projekteve pilot që synojnë ofrimin e stimuljeve për rehabilitimin energjetik të ndërtesave rezidenciale dhe instalimin e paneleve diellore, me subvencione të konsiderueshme të alokuara nga buxheti shtetëror. Këto nisma janë përforcuar nga partneritetet me institucionet financiare ndërkombëtare, si Banka Botërore dhe BERZH, duke rritur më tej shkallën dhe ndikimin e masave të efikasitetit të energjisë. Për më tepër, përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të energjisë shtrihen në sektorin publik, me fonde të dedikuara të alokuara për rehabilitimin e ndërtesave publike në komuna⁷⁵.

Gjatë dekadës së fundit, Serbia ka organizuar dhe ekzekutuar shtatë thirrje publike me qëllim alokimin e fondeve për rritjen e efikasitetit të energjisë në ndërtesa të rëndësishme në nivel lokal. Këto përpjekje kanë rezultuar në implementimin e 107 projekteve, me vlerë totale prej rreth 14.4 milionë euro. Për më tepër, janë nisur iniciativa pilot për të forcuar efikasitetin e energjisë në sektorin rezidencial, ku qeveria ofron stimuj deri në 50 përqind. Nga kjo kanë përfituar rreth 5,000 ekonomi familjare, me investim të kombinuar prej rreth 6 milionë euro.⁷⁶ Rrjedhimisht, ka pasur rritje të konsiderueshme të fondeve të alokuara për financimin e efikasitetit të energjisë nga buxheti i Republikës së Serbisë për vitin 2022, në afërsisht 17 milionë euro, me rreth 10 milionë euro të arkëtuara në vit nga tarifat e kompensimit. Në vitin 2022, këto fonde janë përdorur për renovimin e apartamenteve të banimit, shtëpive familjare dhe ndërtesave të banimit, si dhe instalimin e paneleve diellore në 20,000 ekonomi familjare, me kursim vjetor të prishëm të energjisë prej 196,276,070 kWh⁷⁷. Për më tepër, implementimi i thirrjes së tetë publike për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat e vetëqeverisjes lokale në vitin 2022 shënoi implementimin e parë sipas Direktivës për Efikasitetin e Energjisë. Përafërsisht 5.8 milionë euro nga direktiva janë alokuar për financimin e 38 ndërtesave me rëndësi publike, duke rezultuar në kursim të prishëm të energjisë prej 9 milionë kWh në vit dhe reduktim prej rreth 4,500 tonë

73 Qeveria e Republikës së Serbisë. Plani i Katërt i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë i Republikës së Serbisë për periudhën deri më 31 dhjetor 2021. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:40aa7e23-a6c4-49fc-a773-5659b8906693/RS_4thNEEAP_092021.pdf (Qasja e fundit më: 3 shkurt 2024)

74 Po aty

75 Qeveria e Republikës së Serbisë. Plani i Integruar Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Serbisë për periudhën deri në 2030 me projeksione deri në 2050. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:01992fc5-4981-4ee3-84f8-f1f96830b4ba/INECP_Serbia_ENG_13.06.23percent20.pdf (Qasja e fundit më: 3 shkurt 2024)


76 Qeveria e Republikës së Serbisë. Plani i Katërt i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë i Republikës së Serbisë për periudhën deri më 31 dhjetor 2021. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:40aa7e23-a6c4-49fc-a773-5659b8906693/RS_4thNEEAP_092021.pdf (Qasja e fundit më: 3 shkurt 2024)

77 Po aty

të emetimeve të CO₂ në vit⁷⁸. Për më tepër, këto përpjekje kanë siguruar një hua të Bankës Botërore prej 43 milionë euro dhe një hua të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) prej 43 milionë euro për projekte të fokusuara në energjinë e pastër, efikasitetin e energjisë dhe rehabilitimin e ndërtesave rezidenciale dhe publike lidhur me sistemet e ngrohjes qendrore. Këto projekte synojnë të mbështesin grupet e cenueshme shoqërore dhe të promovojnë kalimin në faturim të bazuar në konsumin e energjisë, me subvencione nga të cilat pritet të përfitojnë rreth 100,000 ekonomi familjare⁷⁹.

Ndërsa gjatë dhjetë viteve të fundit në Serbia janë implementuar shumë projekte, vendi ka arritur të përmbushë vetëm 80 për qind të objektivave për EE (legjislativë dhe jo-legjislativë) duke implementuar projekte në shumën totale prej 415 milionë euro krahasuar me shumën e nevojshme prej 1.6 miliardë euro⁸⁰. Prej këtyre, vlerësohet se rreth 95 milionë euro janë investuar në sektorin rezidencial dhe pjesa tjetër në sektorin publik (figura 12).

Figura 12- Programet e efikasitetit të energjisë në Serbi (mil/EUR) nga 2010 deri 2020.



Burimi: Komuniteti i Energjisë (Raporti Vjetor për EE në Serbi) dhe Qeveria e Serbisë (Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës)

78 Po aty

79 Po aty

80 Komuniteti i Energjisë. Gjurmuesi i Tranzicionit të Energjisë në BP6. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:2077a2ba-805a-4ca2-afcb-91c90ecc0878/EnC_WB6_ETT1_072020.pdf (Qasja e fundit më 29 janar 2024)

4. PIKËPAMJA PËR TË ARDHMEN- ARRITJA E OBJEKTIVAVE TË EE PËR VITIN 2030, PROMOVIMI I PUNËSIMIT DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM EKONOMIK NË BP6

4.1 HYRJE

Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) kanë korniza të forta legislative dhe të politikave që rregullojnë sektorët e tyre të energjisë. Këto korniza azhurnohen vazhdimisht për t'u harmonizuar me zhvillimet dhe objektivat në vijim e sipër të përshkuara në planet e tyre kombëtare për energjinë dhe klimën dhe detyrimet që rrjedhin nga zotimet ndërkombëtare. Të gjitha qeveritë e BP6 janë zotuar për Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe objektivin për arritjen e neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050⁸¹.

Veçanërisht, vendet e BP6 kanë bërë përparim të theksuar në transpozimin e Pakos së Tretë të Energjisë të BE-së, ndërsa Komuniteti i Energjisë raporton për rritje në normat e transpozimit nga 48 për qind në 2018 në 55 për qind në 2020, duke sjellë kështu sektorin e energjisë në harmoni me rregulloret e BE-së dhe standardet ndërkombëtare⁸².

Përpyekjet drejt implementimit të praktikave më të mira ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me shturjen dhe sigurimin e qasjes jo-diskriminuese në infrastrukturën në pronësi të monopoleve të natyrshme, po i afrohen përfundimit në BP6. Për më tepër, krijimi i bursave të energjisë në Mal të Zi, Shqipëri dhe Kosovë pasqyron hapat e rajonit drejt kultivimit të tregjeve të organizuara të energjisë në stilin e BE-së. Megjithëse përmirësimet e efikasitetit të energjisë po ndodhin gradualisht, veçanërisht në ndërtesat publike, hovi i kohëve të fundit me dokumentet strategjike dhe programet e financimit po i shtrin këto përpjekje në sektorin privat në shumicën e ekonomive të BP6⁸³.

81 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Burimi: <https://www.rcc.int/download/docs/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20WB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf> (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

82 OECD. Politika e energjisë. Burimi: [link](#) (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

83 OECD. Tranzicioni i Energjisë së Pastër në Ballkanin Perëndimor. Burimi: <https://t4.oecd.org/south-east-europe/programme/OECD-BN-Clean-Energy-Transition-Oct2022.pdf> (Qasja e fundit më: 29 janar 2024).

Megjithatë, sfidat ngulmojnë për shkak të mungesës së ekspertizës teknike dhe financimit të kufizuar në institucionet përkatëse, si dhe pengesave të tilla si mungesa e certifikatave të ndërtesave dhe e auditorëve të trajnuar, të cilat frenojnë iniciativat për eficiencën e energjisë.⁸⁴

Në fushën e investimeve për eficiencën e energjisë, kompanitë private dhe individët zakonisht i japin përparësi projekteve me periudhë të favorshme kthimi, zakonisht ndërmjet 4-6 vjet. Periudhat më të gjata të kthimit mund të jenë të pranueshme nëse investimet sjellin përfitime shtesë jo-energjetike, të tilla si modernizimi i linjave të prodhimit, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, etj. Periudha mesatare e kthimit të investimeve për projektet e EE është rreth 5 vjet, megjithëse disa iniciativa si ko-gjenerimi në mjediset industriale mund të kenë periudha kthimi më të gjata nga 7 deri në 10 vjet.

Për të nxitur investimet me periudha kthimi më të gjata, qeveritë duhet të ofrojnë mbështetje financiare në formën e granteve, përfitimeve tatimore, subvencionim të normave të interesit të kredive, etj. Këta stimuj do të duhej të synojnë reduktimin e periudhës së kthimit të investimit të konsumatorit në nivel të pranueshëm prej rreth 5 vjetësh. Për më tepër, stimujt mund të lehtësohen përmes financimit nga palët e treta ose kontraktimit të performancës energjetike, duke siguruar që ata të jenë të balancuar për të shmangur mbështetjen e tepruar në fondet publike për përfitimin e konsumatorit.

Të gjitha vendet e gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor janë aktualisht në procesin e formulimit të kontributeve të tyre kombëtare drejt eficiencës së energjisë, burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe reduktimit të emetimeve të gazeve serrë. Bashkimi Evropian dhe Komuniteti i Energjisë i kanë vënë theks të madh eficiencës së energjisë brenda politikave të tyre. Si rezultat, secili vend i BP6 ka përvijuar objektivat e veta kombëtare kumulative ose objektivat tavan që lidhen me EE në politikat kombëtare përkatëse.

Në këtë pjesë, ne do të analizojmë objektivat e identifikuar duke llogaritur investimin e nevojshëm për arritjen e tyre, duke vlerësuar kthimin e investimit duke marrë parasysh çmimet e krizës kundrejt çmimeve normale dhe duke vlerësuar ndikimin e këtyre investimeve në normat e punësimit në planin afatshkurtër dhe afatgjatë.

Për llogaritje përdoret metodologjia e kursimeve kumulative, ku investimet në vitet e hershme barten në vitet në vijim. Prandaj, kjo metodologji favorizon ndërhyrjet e hershme. Ndërsa kjo metodologji i bën llogaritjet e objektivave të lehta për t'u matur, ka shumë kufizime që ulin besueshmërinë e llogaritjeve, duke përfshirë riskun e mbivlerësimit, faktorët e jashtëm si ndryshimet e sjelljes së faktorit njeri, pastaj performanca dhe përmirësimi teknologjik, disponueshmëria e të dhënave në verifikimin e kursimeve dhe ndryshimeve të politikave gjatë raportimit në sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, etj. Pavarësisht nga këto kufizime, objektivat kumulative për eficiencën e energjisë mund të jenë ende mjet i vlefshëm për nxitjen e diskutimit të politikave mbi masat e eficiencës së energjisë, mund t'u mundësojnë politikëbërësve të kuptojnë urgjencën e investimit në eficiencën e energjisë, dhe ndikimin e përgjithshëm në zhvillimin ekonomik të vendeve përkatëse të BP6.

84 Po aty


Llogaritjet për objektivat e EE u kryen sipas dy skenarëve. Në skenarin bazë (nëntabela a), u mor në konsideratë një miratim më i shpejtë i masave të EE, përfshirë ato të prezantuara nëpërmjet mbështetjes së drejtpërdrejtë buxhetore të BE-së në përgjigje ndaj krizës energjetike. Nëntabela b konsideron një përvetësim më të ngadaltë të masave dhe është dhënë për qëllime ilustruese, për të kuptuar koston e rritur të arritjes së objektivave të EE të vendosura nga EnC. Duke pasur parasysh shumësinë e programeve dhe mundësive për investime në rajon, si dhe kushtet përkatëse unike, llogaritjet e sakta janë të vështira në këtë moment. Së këndejmi, u zbatua një rregull parimore e përgjithshme, duke vlerësuar se për çdo ktoe të kursyer do të nevojitej investim prej rreth 6.1 milionë euro.

4.2 SHQIPËRIA

Shqipëria ka ndërmarrë hapa proaktivë drejt efiçencës së energjisë dhe veprimit klimatik me prezantimin e objektivave përkatëse të efiçencës së energjisë për vitin 2030 dhe politikave dhe masave shoqëruese, të përshkruara në PKEK të adoptuar në shkurt 2022. Mirëpo, këto masa nuk janë harmonizuar me objektivat e vitit 2030 të vendosura nga Komuniteti i Energjisë⁸⁵.

Me rritjen e ngadaltë të konsumit primar të energjisë në Shqipëri në 20 vitet e fundit, me mesatare vjetore prej 0.5 për qind⁸⁶ dhe objektivat kumulative të EE të vendosura në 599.54 ktoe⁸⁷, Shqipëria pritet të bëhet një nga vendet me më pak intensitet energjetik në rajon.

Figura 13- Intensiteti energjetik i Shqipërisë



Burimi: Eurostat

85 Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Projekt-Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Shqipërisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:a0c2b8a8-96c8-4423-993a-537cf51daa65/Draft_NECP_AL_percent202021.pdf. (Qasja e fundit më: 29 janar 2024)

86 Eurostat. Konsumi primar i energjisë. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/web/products-datasets/-/sdg_07_10. (Qasja e fundit më: 29 janar 2024)

87 Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Projekt-Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Shqipërisë. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:a0c2b8a8-96c8-4423-993a-537cf51daa65/Draft_NECP_AL_percent202021.pdf. (Qasja e fundit më: 29 janar 2024)

Intensiteti energjetik në Shqipëri është në rënie me mesatare vjetore prej 3 për qind, duke arritur 204.95 KGOE për mijë euro, krahasuar me mesataren e BE-së (116.33 KGOE për mijë euro), por po ashtu është më i lartë se mesatarja e vendeve të rajonit (360.21 KGOE për mijë euro)⁸⁸.

Sipas Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, qeveria e Shqipërisë ka vendosur objektiv kumulativ prej 599.54 ktoe për vitin 2031, që do të thotë se përvetësimi më i shpejtë i masave të EE mund të çojë në arritjen e objektivave të EE me investim prej përafërsisht 588.89 milionë euro, krahasuar me 637.69 milionë euro në rast të përvetësimit më të ngadaltë, sipas tabelës më poshtë.

Tabela 1-Skenarët e synuar për EE në Shqipëri


Nëntabela (a)	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	Gjithsej Kursime kumulative (ktoe)	Nëntabela (b)	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	Gjithsej (ktoe)
	12	12	12	12	12	12	12	12	12	12			10	10	10	10	10	10	10	10	10	10	
22	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	12	22	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	10
23	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	25	23	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	19
24	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	38	24	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	31
25	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	52	25	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	43
26	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	62	26	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	55
27	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	68	27	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	70
28	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	75	28	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	80
29	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	82	29	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	90
30	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	89	30	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	97
31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	96.54	31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	104.54
Gjithsej (ktoe)	12	25	38	52	62	68	75	82	89	96.54	599.54	Gjithsej (ktoe)	10	19	31	43	55	70	80	90	97	104.54	

Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Mesatarisht, qeveria shqiptare në bashkëpunim me sektorin privat, IFN-të, institucionet financiare të brendshme dhe partnerët e zhvillimit do të duhej të investojë rreth 58 milionë euro në vit në programe dhe skema për promovimin e EE.

88 Eurostat. Intensiteti energjetik. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/nrg_ind_ei/default/table?lang=en. (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)


Figura 14- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Shqipëri për të arritur objektivat e përcaktuara për EE.



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Energjia e kursyer falë masave të implementuara arrin në 6,972,650.20 MWh. Në skenarin bazë, nëse kjo energji elektrike do të importohet, do t'u kushtonte klientëve/ qeverisë afërsisht 418 milionë euro gjatë viteve tipike, bazuar në çmimin mesatar të energjisë elektrike në Hupex prej 60 euro/MWh (në vitin 2023). Mirëpo, gjatë periudhave të luhatjeve të tregut (2021-2022) kur çmimi mesatar i energjisë elektrike ishte 250 euro për MWh, kostoja do të ishte mesatarisht rreth 1.7 miliardë euro.

Figura 15- Kostoja e energjisë së kursyer në Shqipëri sikur të importohet në EUR.



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP


4.3 BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Bosnja dhe Hercegovina (BeH) po bën përpjekje të bashkërenduara për të rritur eficiencën e energjisë nëpër sektorë të ndryshëm, duke synuar të forcojë qëndrueshmërinë, të pakësojë përdorimin e energjisë dhe të lehtësojë pasojat mjedisore. Pavarësisht përparimeve të fundit, BeH përballet me sfida në optimizimin e përdorimit të energjisë për shkak të infrastrukturës së vjetruar, praktikave jo-eficiente dhe mungesës së politikave gjithëpërfshirëse.

Për të trajtuar këto pengesa, qeveria boshnjake, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe palët e interesuara, ka vënë në veprim masa për të avancuar eficiencën e energjisë. Këto përpjekje përfshijnë një spektër iniciativash që synojnë përmirësimin e performancës së energjisë në ndërtesa, avancimin e proceseve industriale dhe promovimin e sistemeve të qëndrueshme të transportit.

Për më tepër, BeH po përpjeket në mënyrë aktive të harmonizojë politikat dhe strategjitë e saj të eficiencës së energjisë me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian, duke përafëruar përpjekjet e saj më të gjera integruese me BE-në. Megjithatë, gjatë dekadës së fundit, konsumi primar i energjisë ka shënuar rritje mesatare vjetore prej 2.69 për qind⁸⁹. Ngjashëm me Kosovën, sektori i energjisë në BeH shpërfaq një nga nivelet më të larta të intensitetit energjetik në rajon dhe Evropë. Ndonëse ka pasur rënie të intensitetit energjetik gjatë tre viteve të fundit, ai mbetet i theksuar me 443.36 KGOE për mijë euro⁹⁰.

Figura 16- Intensiteti energjetik në BeH




Burimi: Eurostat

89 Eurostat. Konsumi primar i energjisë. Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/sdg_07_10 (Qasja e fundit më: 29 janar 2024).

90 Eurostat. Intensiteti energjetik. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/nrg_ind_ei/default/table?lang=en (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

Aktualisht BeH është në procesin e zhvillimit të strategjive kombëtare, duke përfshirë Planin e Energjisë dhe Klimës. Prandaj, deri më sot nuk ka objektiva zyrtarë për eficientësi të energjisë, duke e bërë të pamundur llogaritjen e përpiktë të investimit të nevojshëm për periudhën e ardhshme dhjetëvjeçare. Megjithatë, nëse ngjashmëritë me rajonin vazhdojnë, pritet që BeH të arrijë një objektiv mesatar prej 400 ktoe dhe investim total të përbashkët prej rreth 460 milionë euro deri në vitin 2031.

Figura 17- Kostoja e energjisë së kursyer në BeH sikur të importohej në EUR.



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Vlerësohet se energjia e kursyer për arritjen e objektivave shkon në 4,652,000 MWh. Në skenarin bazë, nëse kjo energji elektrike do të importohej, do t'u kushtonte klientëve/ qeverisë afërsisht 280 milionë euro gjatë viteve tipike, bazuar në çmimin e energjisë elektrike në Hupex prej 60 euro/MWh. Megjithatë, gjatë luhatjeve të tregut, kostoja do të ishte mesatarisht rreth 1.2 miliardë euro.

4.4 KOSOVA


Gjatë dekadave të shkuara, konsumi primar i energjisë është rritur me mesatare vjetore prej 1.4 për qind mes viteve 2008 dhe 2020.⁹¹ Norma e rritjes u moderua nga fundi i dekadës, por u ndikua edhe nga efektet afatshkurtra (pandemia e COVID-19). Konsumi final i energjisë ka pasur trend të ngjashëm në këtë periudhë, me rritje mesatare vjetore prej 2.3 për qind, duke arritur në 1,525 ktoe në vitin 2020.⁹² Ndonëse intensiteti energjetik në Kosovë është përmirësuar dukshëm që nga viti 2008, ai është ende shumë i lartë në krahasim me mesataren e BE-së (116.33 KGOE për mijë euro), por po ashtu është më i lartë se mesatarja e vendeve të rajonit (360.21 KGOE për mijë euro)⁹³.

91 Eurostat. Konsumi primar i energjisë. Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/sdg_07_10 (Qasja e fundit më: 29 janar 2024).

92 Eurostat. Konsumi final i energjisë sipas sektorit. Burimi: <https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/ten00124/default/table?lang=en> (Qasja e fundit më: 29 janar 2024).

93 Eurostat. Konsumi primar i energjisë. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/sdg_07_10/default/table?lang=en (Qasja e fundit më: 29 janar 2024).

Figura 18- Intensiteti energjetik i Kosovës



Burimi: Eurostat

Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje në konsumin primar dhe final të energjisë mund t'i atribuohet zhvillimit ekonomik të Kosovës, trendit të intensitetit të lartë energjetik dhe mungesës së investimeve në masat e efijencës së energjisë në sektorin e ekonomive familjare.

Ndërsa siç u përmend më herët, në vitet e fundit, Kosova ka prezantuar disa politika dhe programe për të promovuar efijencën e energjisë, ka ende punë për të bërë drejt arritjes së objektivave të efijencës së energjisë. Në përcaktimin e objektivave, strategjia e energjisë ka përdorur një metodologji që është në favor të investimeve të mëhershme kundrejt atyre në vitet e mëvonshme. Siç shihet në tabelën më poshtë, nëse Kosova do të ndërmernte qasje më proaktive do të përmbushte objektivin prej 283 ktoe kumulative të kursyera⁹⁴ me investim total prej 322 milionë, krahasuar me 366 milionë për përvetësimin më të ngadaltë të masave.

94 Republika e Kosovës. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës. Burimi: <https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Energy-Strategy-of-the-Republic-of-Kosovo-2022-2031-1-1.pdf>. (Qasje e fundit më: 29 janar 2024).


Tabela 2- Skenarët e synuar për efizienzë të energjisë në Kosovë

Sub table (a)											Total Cumulative savings (ktoe)											
	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31		22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	
22	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	22	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7	2.7
23	X	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	6.2	23	X	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1
24	X	X	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	6.1	24	X	X	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1
25	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	25	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4
26	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	26	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4
27	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	27	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4
28	X	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	28	X	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	5.4	5.4
29	X	X	X	X	X	X	X	5.4	5.4	5.4	29	X	X	X	X	X	X	X	8	8	8	8
30	X	X	X	X	X	X	X	X	5.5	5.5	30	X	X	X	X	X	X	X	X	9	9	9
31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	5.4	31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	8.5	8.5
Total	2.7	8.9	15	20.4	25.8	31.2	36.6	42	47.5	52.9	Total	2.7	7.8	12.9	18.3	23.7	29.1	34.5	42.5	51.5	60	

Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Në skenarin e përvetësimit më të shpejtë, për të arritur kursimet e synuara në strategjinë e energjisë, Qeveria e Kosovës së bashku me institucionet financiare, partnerët zhvillimorë dhe sektorin privat duhet të investojnë rreth 322 milionë euro, me mesatare të vlerësuar prej 32 milionë në vit, sipas grafikut të mëposhtëm.

Figura 19- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Kosovë për të arritur objektivat e përcaktuara për EE.




Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Energjia e kursyer falë masave të implementuara arrin në 3,291,290 MWh. Në skenarin bazë, nëse kjo energji elektrike do të importohet, do t'u kushtonte klientëve/qeverisë afërsisht 200 milionë euro gjatë viteve tipike, bazuar në çmimin e energjisë elektrike në Hupex prej 60 euro/MWh. Megjithatë, gjatë luhatjeve të tregut (kur çmimet shkojnë

deri në 250 EUR/MWh⁹⁵), kostoja do të jetë mesatarisht rreth 800 milionë euro, duke e bërë investimin të nevojshëm, të zgjuar dhe të përballueshëm.

Figura 20- Kostoja e energjisë së kursyer në Kosovë sikur të importohet në EUR.




Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

4.5 MALI I ZI

Promovimi i efikasitetit të energjisë (EE) në Malin e Zi është vendimtar për arritjen e qëndrueshmërisë, uljen e kostove të energjisë dhe përmbushjen e objektivave klimatike. Mali i Zi është një nga vendet me intensitetin më të ulët energjetik në rajon, duke arritur 283.2 KGOE për mijë euro krahasuar me mesataren e BE-së⁹⁶. Vendi do të duhej të përmirësojë më tej rregulloret e politikave në avancimin e objektivave të implementimit të efikasitetit të energjisë.

Figura 21- Intensiteti energjetik i Malit të Zi




Source: Eurostat

95 HupX. Të dhëna historike. Burimi: <https://hupx.hu/en/market-data/dam/historical-data> (Qasja e fundit më: 24 shkurt 2024)

96 Eurostat. Intensiteti energjetik. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/nrg_ind_ei/default/table?lang=en (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

Ndërsa Mali i Zi është ende duke finalizuar draftin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, i cili duhet të harmonizojë objektivat e eficiencës së energjisë për vitin 2030 me objektivat për vitin 2030 të vendosura nga Komuniteti i Energjisë, qeveria e Malit të Zi ende nuk ka përcaktuar objektivat kumulative dhe skenarët e mundshëm të implementimit. Megjithatë, në Strategjinë e Energjisë, qeveria e Malit të Zi synon të investojë rreth 439.4 milionë euro në eficiencën e energjisë deri në vitin 2030, duke arritur objektiv mesatar kumulativ të llogaritur prej rreth 390 ktoe⁹⁷.

Figura 22- Kostoja e energjisë së kursyer në Malin e Zi sikur të importohet në EUR.



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP


Energjia e kursyer nga masat e implementuara arrin në 837,709 MWh, duke çuar në kursime nga 50 milionë në 210 milionë euro për dhjetë vitet e ardhshme.

97 Qeveria e Malit të Zi. Strategjia për Zhvillimin Energjetik të Malit të Zi deri në vitin 2030. Burimi: <https://faolex.fao.org/docs/pdf/mne208502.pdf>. (Qasja e fundit më: 1 shkurt 2024)

4.6 MAQEDONIA E VERIUT

Me rënien e ngadaltë të konsumit primar të energjisë në Maqedoninë e Veriut në 20 vitet e fundit, me rënie mesatare vjetore prej 0.5 për qind⁹⁸ a dhe objektivat kumulative të vendosura në 147.2 ktoe⁹⁹, NMaqedonia e Veriut është vendi me intensitetin më të ulët energjetik në rajon.

Figura 23- Intensiteti energjetik i Maqedonisë së Veriut



Burimi: Eurostat

Intensiteti energjetik në Maqedoninë e Veriut është në rënie me mesatare vjetore prej 2.7 për qind, duke arritur 204.95 KGOE për mijë euro, krahasuar me mesataren e BE-së (116.33 KGOE për mijë euro), por po ashtu është më i ulët se mesatarja e vendeve të rajonit (360.21 KGOE për mijë euro)¹⁰⁰.

Që nga anëtarësimi në EnC, Maqedonia e Veriut ka përmirësuar legjislacionin e brendshëm dhe së fundmi ka adoptuar objektivat e efijencës së energjisë për vitin 2030 në PKEK-në e adoptuar, duke e përfruar atë me objektivat për 2030 të vendosura nga Komuniteti i Energjisë. Sipas Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, qeveria e Maqedonisë së Veriut ka vendosur objektiv kumulativ prej 147.2 ktoe për vitin 2031¹⁰¹, që do të thotë se përvetësimi më i shpejtë i masave të EE mund të çojë në arritjen e objektivave të EE me investim të përafërt prej 165.31 milionë euro.

98 Eurostat. Konsumi primar i energjisë. Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/sdg_07_10 (Qasja e fundit më: 29 janar 2024).

99 Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:bbb63b32-6446-4df8-adc6-c90613daf309/Draft_NECP_NM_percent202020.pdf (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

100 Eurostat. Intensiteti energjetik. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/nrg_ind_ei/default/table?lang=en (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

101 Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës. Burimi: https://www.energy-community.org/dam/jcr:bbb63b32-6446-4df8-adc6-c90613daf309/Draft_NECP_NM_percent202020.pdf (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)


Tabela 3- Skenarët e synuar për efijencë të energjisë në Maqedoninë e Veriut

Sub table (a)	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	1472	Sub table (b)	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	
22	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2			22	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
23	X	4	4	4	4	4	4	4	4	4			23	X	2	2	2	2	2	2	2	2	2
24	X	X	4	4	4	4	4	4	4	4			24	X	X	3	3	3	3	3	3	3	3
25	X	X	X	2	2	2	2	2	2	2			25	X	X	X	2	2	2	2	2	2	2
26	X	X	X	X	1	1	1	1	1	1			26	X	X	X	X	3	3	3	3	3	3
27	X	X	X	X	X	1	1	1	1	1			27	X	X	X	X	X	3	3	3	3	3
28	X	X	X	X	X	X	4	4	4	4			28	X	X	X	X	X	X	5	5	5	5
29	X	X	X	X	X	X	X	X	3	3			29	X	X	X	X	X	X	X	3	3	3
30	X	X	X	X	X	X	X	X	X	3,1			30	X	X	X	X	X	X	X	X	3,1	3,1
31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X			31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	3
Total	2	6	10	12	13	14	18	21	24,1	27,1			Total	2	4	7	9	12	15	20	23	26,1	29,1

Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Mesatarisht, qeveria e Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me partnerët do të duhej të investojë rreth 16 milionë euro në vit në programe dhe skema për promovimin e EE.


Figura 24- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Maqedoninë e Veriut për të arritur objektivat e përcaktuara për EE.



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Energjia e kursyer falë masave të implementuara arrin në 1,711,936.00 MWh. Në skenarin bazë, nëse kjo energji elektrike do të importohet, do t'u kushtonte klientëve/ qeverisë afërsisht 1.2 milionë euro krahasuar me 427 milionë gjatë luhatjeve në treg.

Figura 25- Kostoja e energjisë së kursyer në Maqedoninë e Veriut sikur të importohet në EUR.




Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

4.7 SERBIA

Gjatë dekadës së fundit, konsumi primar i energjisë në Serbi është rritur në mënyrë të qëndrueshme me mesatare vjetore prej 2.4 për qind¹⁰². Për më tepër, intensiteti energjetik gjithashtu ka rënë ngadalë, ndërkohë që ende është ndër më të lartët krahasuar me mesataren e BE-së (116.33 KGOE për mijë euro), por po ashtu është më i lartë se mesatarja e vendeve të rajonit (360.21 KGOE për mijë euro)¹⁰³.

Figura 26- Intensiteti energjetik i Serbisë



Burimi: Eurostat

¹⁰² Eurostat. Konsumi primar i energjisë. Burimi: https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/sdg_07_10 (Qasja e fundit më: 29 janar 2024).

¹⁰³ Intensiteti energjetik. Burimi: https://ec.europa.eu/Eurostat/databrowser/view/nrg_ind_ei/default/table?lang=en (Qasja e fundit më: 24 janar 2024)

Sipas Strategjisë së Energjisë, qeveria e Serbisë ka vendosur objektiv kumulativ prej 506 ktoe për vitin 2031¹⁰⁴, që do të thotë se përvetësimi më i shpejtë i masave të EE mund të çojë në arritjen e objektivave të EE me investim prej përafërsisht 494.1 milionë euro, krahasuar me 677.1 milionë euro në rast të përvetësimit më të ngadaltë, sipas tabelës më poshtë.

Tabela 4- Skenarët e synuar për efikasitet të energjisë në Serbi


Sub table (a)	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	Gjithsej Kursime kumulative (ktoe)	506	Sub table (b)	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
	22	9	9	9	9	9	9	9	9	9				9	22	6	6	6	6	6	6	6	6
23	X	13	13	13	13	13	13	13	13	13	23	X	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6
24	X	X	13	13	13	13	13	13	13	13	24	X	X	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6
25	X	X	X	8	8	8	8	8	8	8	25	X	X	X	7	7	7	7	7	7	7	7	7
26	X	X	X	X	9	9	9	9	9	9	26	X	X	X	X	13	13	13	13	13	13	13	13
27	X	X	X	X	X	5	5	5	5	5	27	X	X	X	X	X	14	14	14	14	14	14	14
28	X	X	X	X	X	X	6	6	6	6	28	X	X	X	X	X	X	15	15	15	15	15	15
29	X	X	X	X	X	X	X	6	6	6	29	X	X	X	X	X	X	X	14	14	14	14	14
30	X	X	X	X	X	X	X	X	6	6	30	X	X	X	X	X	X	X	X	15	15	15	15
31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	6	31	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	15	15
Total	9	22	35	43	52	57	63	69	75	81	Total	6	12	18	25	38	52	67	81	96	111	111	111

Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Mesatarisht, qeveria e Serbisë në bashkëpunim me sektorin privat, IFN-të, institucionet financiare të brendshme dhe partnerët e zhvillimit do të duhej të investojë rreth 50 milionë euro në vit në programe dhe skema për promovimin e EE.

104 Qeveria e Serbisë. Strategjia për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë së Republikës së Serbisë për periudhën deri në 2025 me projeksione deri në 2030. Burimi: <https://meemp-serbia.com/wp-content/uploads/2018/09/Legislative-Energy-Sector-Development-Strategy-of-the-Republic-of-Serbia-for-the-period-by-2025-with-projections-by-2030.pdf> (Qasja e fundit më: 21 janar 2024)


Figura 27- Investimet e vlerësuara të ardhshme në EE për vit (mil/euro) në Serbi për të arritur objektivat e përcaktuara për EE.



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Energjia e kursyer falë masave të implementuara arrin në 5,884,780 MWh. Në skenarin bazë, nëse kjo energji elektrike do të importohet, do t'u kushtonte klientëve/qeverisë afërsisht 353 milionë euro gjatë viteve tipike, bazuar në çmimin e energjisë elektrike në Hupex prej 60 euro/MWh. Megjithatë, gjatë luhatjeve të tregut, kostoja do të ishte mesatarisht rreth 1.4 miliardë euro.

Figura 28- Kostoja e energjisë së kursyer në Serbi sikur të importohet në EUR.



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

4.8 MUNDËSITË E PUNËSIMIT PËR TË RRRITUR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM EKONOMIK.

Nivelet e larta të papunësisë në Ballkanin Perëndimor (BP6), mesatarisht 15.5 për qind, u përkeqësuan nga ndikimi i pandemisë së COVID-19 në tregun e punës. Ka disa faktorë që kontribuojnë në këtë shkallë të lartë papunësie, ku përfshihen mundësitë e kufizuara ekonomike, investimet e pamjaftueshme, sistemet e dobëta të arsimit dhe trajnimit dhe paqëndrueshmëria politike. Ekonomia e vogël dhe e pazhvilluar e rajonit, së bashku me burimet dhe infrastrukturën e kufizuar, paraqesin sfida në krijimin e mundësive të mjaftueshme të punësimit formal për të përmbushur kërkesën.


Shqetësim i veçantë është shkalla e lartë e papunësisë të rinjtë. Megjithatë, investimet në efizienzën e energjisë ofrojnë përfitime përtej përmirësimit të kushteve të jetesës dhe uljes së varfërisë energjetike. Ato gjithashtu injektojnë fonde për të stimuluar rritjen ekonomike dhe mund të mbështesin shumë familje përmes mundësive të punësimit direkt, indirekt dhe të nxitur.

Rritja e punësimit që rezulton nga masat e efizienzës së energjisë, veçanërisht në sektorët e ndërtesave dhe renovimit, mund të ketë efekt të përhapjes valore pozitive në industrinë e ndërlidhura. Për shembull, investimi në zëvendësimin e dritareve me dritare më eficiente mund të krijojë punësim direkt me orar të plotë në kompanitë përkatëse, duke çuar në rritje të punësimit indirekt ndër sektorë si prodhimi i plastikës. Kjo, nga ana tjetër, gjeneron mundësi të mëtejshme punësimi në industri të tilla si restorante, hotele dhe shitje me pakicë.

Një studim i kategorizon investimet në efizienzën e energjisë në tre sektorë kryesorë: rezidencial, komercial dhe industrial. Studimi konstaton se investimet në sektorin rezidencial kanë ndikim më të madh të drejtpërdrejtë në punësim për shkak të punës intensive manuale që është e nevojshme për instalimin e pajisjeve. Megjithatë, nëpër të gjithë sektorët, punësimi i nxitur—që rezulton nga fluksi i parave në ekonomitë familjare—ka ndikim më të madh në krijimin e vendeve të punës në krahasim me punësimin direkt.

Për shembull, kur llogaritet ndikimi i investimit prej 2.4 miliardë euro sipas llogaritjeve të mëparshme në efizienzën e energjisë në të gjithë sektorët (industrial, rezidencial dhe komercial) kjo nxjerr në pah potencialin e lartë për krijimin e vendeve të punës. Ndërsa ndikimet e drejtpërdrejta të punësimit ndryshojnë nëpër sektorë, efekti i përgjithshëm në krijimin e vendeve të punës, veçanërisht nëpërmjet punësimit të nxitur, është i ndjeshëm, duke theksuar potencialin e investimeve në efizienzën e energjisë për të adresuar sfidat e papunësisë në Ballkanin Perëndimor.


Figura 29- Vende pune të krijuara nga investimet në EE- sektori rezidencial (2021-2031).



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Sipas metodologjisë IMPLAN të ilustruar në figurën 29, parashikohen të krijohen rreth 31,000 vende pune neto (që përfshijnë punësim direkt, indirekt dhe të nxitur) me investim total prej 2.4 miliardë euro. Kjo përkthehet në afërsisht 12.5 vende pune neto për çdo milion euro të investuar, duke përfshirë 3.7 vende pune direkte, 3.8 vende punë indirekte dhe 5 vende pune të nxitura. Këto përllogaritje tregojnë ndikim relativisht të barabartë në krijimin e vendeve të punës në të tre sektorët (rezidencial, industrial dhe komercial).


Figura 30- Vende pune të krijuara nga investimet në EE- sektori komercial (2021-2031).



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

Ndër sektorë, ai me numrin më të madh të punësimeve të krijuara është sektori komercial, por sektori me ndikimin më të madh në uljen e lakores së kërkesës për energji është ai i ekonomive familjare për shkak të natyrës së konsumit të energjisë në BP6.

Figura 31- Vende pune të krijuara nga investimet në EE- sektori industrial (2021-2031).



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP


Megjithatë, këto projeksione anashkalojnë mundësitë e punësimit që rrjedhin nga kursimet kapitale që rezultojnë nga masat e efijencës së energjisë (EE), veçanërisht në sektorin komercial dhe atë industrial, ku ndikimi i mundshëm çmohet të jetë i konsiderueshëm. Kjo metodologji shqyrton investimet në mbi 70 sektorë të ekonomisë dhe i kategorizon ato sipas llojit (si çati, izolim, solare, dyer dhe dritare, etj.). Ndërkohë që kjo qasje ofron shumë përparësi, ajo gjithashtu ka disa kufizime. Ndër to përfshihet natyra e saj statike, pasi IMPLAN nuk përfshin luhatjen e çmimeve. Për më tepër, metodologjia u zhvillua me fokus në çmimet e tregut në Shtetet e Bashkuara.

Hulumtimi i kryer nga Këshilli Amerikan për Efijencën e Energjisë sugjeron që investimet në EE kanë potencialin për të krijuar afërsisht 7 vende pune neto për çdo milion euro të kursyer përmes këtyre masave¹⁰⁵. Këto vende pune janë rezultat i shpenzimeve të reduktuara të energjisë elektrike, ku fondet e kursyera ri-investohen në fusha të ndryshme si zgjerimi i fuqisë punëtore, rritja e rendimentit të prodhimit ose shpenzime të tjera.

Prandaj, duke arritur objektivin e 2008 ktoe (ekuivalent me kursimin e 23,353.51 GWh) me çmim minimal prej 60 EUR për MWh, Ballkani Perëndimor mund të gjenerojë potencialisht deri në 9,808 vende pune për një periudhë 20-vjeçare, duke marrë parasysh jetëgjatësinë e vlerësuar të masave EE.

¹⁰⁵ ACEEE. Si efijencia e energjisë krijon vende pune. Burimi: <https://www.aceee.org/files/pdf/fact-sheet/ee-job-creation.pdf>. (Qasja e fundit më: 21 janar 2024)

Figura 32- Vende pune afatgjata të krijuara nga investimi në EE (2031-2051)



Burimi: përpiluar dhe llogaritur nga GAP

PËRFUNDIM

Rajoni i BP6 shquhet si një nga rajonet me shfrytëzimin më të lartë të thëngjillit dhe intensitet energjetik më të madh në Bashkimin Evropian, ku nivelet e intensitetit energjetik janë tri herë më të larta sesa mesatarja e BE-së. Për shkak të sistemit jo-fleksibil dhe jo të besueshëm të energjisë dhe luhatjeve të fundit të tregut të energjisë, popullsia e cenueshme brenda BP6 është ndikuar ndjeshëm, duke çuar në rritjen e varfërisë energjetike. Pavarësisht përpjekjeve qeveritare për të trajtuar krizën përmes politikave dhe programeve të ndryshme, barra mbetet e pamohueshme. Gjatë dy viteve të fundit, vendet e BP6 kanë alokuar më shumë se 500 milionë euro për të zbutur krizën energjetike; megjithatë, luhatjet e tregut kanë çuar në rritje mesatare prej 10 për qind të çmimeve të energjisë elektrike në të gjitha vendet e BP6.

Implementimi i masave të efijencës së energjisë është vendimtar jo vetëm për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, por edhe për nxitjen e zhvillimit ekonomik, për stabilitetin dhe pavarësinë energjetike. Si nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, vendet e BP6 janë të detyruara të adoptojnë direktivat për EE, megjithatë sfidat në përmbushjen e objektivave të përcaktuara ngulmojnë, veçanërisht në sektorin e ndërtimit ku nevojiten investime të konsiderueshme në rinovime.

Ndërkohë që mbështetja ndërkombëtare ka qenë e pranishme, ajo nuk ka arritur të trajtojë nevojat e rajonit për investime. Përveç Bosnjës e Hercegovinës, të gjitha vendet në rajon nuk arrijnë të përmbushin objektivin e përcaktuar nga EnC. Investimet e nevojshme për të arritur objektivat shkuan në rreth 1.06 miliardë euro midis 2010 dhe 2020, që përfaqëson vetëm 30 për qind të nevojave të identifikuar për investime. Për më tepër, ky investim është drejtuar në masë të madhe drejt ndërtesave publike, me shumë pak mbështetje dhënë sektorit privat. Ky investim barazohet me rreth 10,711,230 MWh energji të kursyer kumulative ose 643 milionë euro në kursime të importit të energjisë gjatë periudhave të rregullta të tregut dhe 2.67 miliardë euro gjatë luhatjeve të tregut si në vitet 2021 dhe 2022.

Duke ecur përpara, vendet e BP6 kanë identifikuar objektivat e politikave dhe kanë miratuar planet e tyre kombëtare të energjisë dhe klimës. Prandaj, dhënia prioritet dhe përshpejtimi i investimeve në renovimin e ndërtesave dhe masat për EE janë identifikuar si të domosdoshme për të arritur standarde më të larta jetese, kursime energjie dhe zhvillim të përgjithshëm ekonomik. Në këto dokumente strategjike, efijencia e energjisë shfaqet si politikë vendimtare dhe e pa gabueshme për rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke ofruar rrugë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe harmonizimit me politikat e Bashkimit Evropian dhe Komunitetit të Energjisë. Ndërsa Serbia kryeson në këtë progres, vendet e tjera të BP6 kanë vendosur gjithashtu politika dhe objektiva për EE, duke hedhur themelet për implementimin e programeve.

Investimi i nevojshëm për të arritur objektivat e EE në rajonin e BP6 vlerësohet në rreth 2.4 miliardë euro gjatë dekadës së ardhshme, duke rezultuar në ulje të konsiderueshme të kërkesës kumulative për energji me 23,353.51 GWh. Këto përpjekje priten të sjellin kursime të konsiderueshme buxhetore prej 1.4 miliardë euro gjatë viteve të rregullta dhe 5.8 miliardë euro gjatë periudhave të luhatjeve të çmimeve.

E rëndësishmja është që përfitimet e EE shtrihen përtej konsideratave ekonomike, duke përfshirë gjenerimin e punësimit, zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen e komuniteteve lokale. Parashikohet që rreth 31,000 vende pune neto do të krijohen drejt-përdrejt në aktivitetet e lidhura me EE gjatë dekadës së ardhshme, ndërsa 9,808 individë të tjerë do të fitojnë mundësi punësimi indirekt përmes kursimeve të energjisë në sektorin privat.

Pavarësisht progresit të bërë, mbetet një hendek i theksuar në arritjen e objektivave të EE, kryesisht për shkak të kufizimeve buxhetore me të cilat përballen qeveritë në rajonin e BP6. Si rezultat, ekziston nevoja e ngutshme për fokus më të madh në ndërtimin dhe fuqizimin e sektorit privat, si dhe lehtësimin e mekanizmave financues për të mundësuar angazhimin e tij aktiv në iniciativat e EE. Kjo mund të arrihet duke mbështetur institucionet financiare në rritjen e mëtejshme të ofertave të huadhënies, krijimin e fondeve të garancisë për të hequr riskun e investimeve, ndërtimin e skemave të investimeve pa kosto fillestare (pay-as-you-save) dhe ofrimin e granteve/subvencioneve. Megjithatë, për ta bërë këtë, do të duhet të përgatitet fuqi punëtore e aftë prej më shumë se 30 mijë punëtorësh për të implementuar skemat, duke garantuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve.

REKOMANDIME

Këto rekomandime synojnë të nxisin implementimin efektiv të objektivave të efijencës së energjisë në vendet përkatëse, duke kontribuar në objektivat e vendosura për EE, përmirësimin e mundësive të punësimit, rritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe sigurinë energjetike në rajon.

Shqipëria: Për të rritur efijencën e energjisë në Shqipëri, do të duhej të ndërmerren disa veprime. Së pari, do të duhej të rishikohet legjislacioni kombëtar në mënyrë që të fuqizohet sektori privat për të drejtuar tranzicionin e energjisë. Përveç kësaj, aktivizimi i Fondit të Efijencës së Energjisë të krijuar enkas do të ofronte financim thelbësor dhe stimuj për projektet e efijencës së energjisë. Ky fond mund të kapitalizohet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fondet e qeverisë, grantet ndërkombëtare dhe kontributet nga partnerët e sektorit privat. Për më tepër, promovimi i rritjes së Kompanive të Shërbimeve të Energjisë (KSHE) do të lehtësonte ofrimin e zgjidhjeve të efijencës së energjisë pa kosto fillestare për sektorin privat. Së fundi, duke u mbështetur nga përvoja me skemat e financuara nga BE, do të duhej të krijohen dhe të implementohen programe të rregullta të efijencës së energjisë.

Bosnja dhe Hercegovina: Në BeH, janë duke u zhvilluar përpjekje për të avancuar objektivat e efijencës së energjisë, por nevojiten më shumë veprime. Do të duhej të adoptohet legjislacioni dytësor për të trajtuar boshllëqet në implementim, veçanërisht në fusha të tilla si prokurimi publik dhe kontratat e standardizuara për KSHE . Transpozimi i Direktivës së ndryshuar për efijencën e energjisë dhe Rregullores së etiketimit të energjisë në legjislacionin kombëtar ka rëndësi vendimtare. Për më tepër, do të ishte i dobishëm lehtësimi i investimeve të sektorit privat në projektet e EE përmes mekanizmave financiarë, siç janë kreditë e gjelbra.

Kosova: Për të rritur efijencën e energjisë në Kosovë, do të duhej të prezantohen mekanizma të rinj financues, të përshtatur enkas për sektorët e industrisë dhe transportit. Sigurimi i fluksit të qëndrueshëm të financimit në Fondin e Efijencës së Energjisë dhe

zgjerimi i fushëveprimit të tij për të mbështetur iniciativat më të gjera të tranzicionit të energjisë ka rëndësi thelbësore. Zhvillimi i tregut të qëndrueshëm për KSHE-të dhe rritja e mbështetjes së ofruar nga Fondi i Garancisë Kreditore mund të zbusë më tej rreziqet që lidhen me investimet e sektorit privat. Do të duhej të zhvillohen gjithashtu strategji plotësuese për të promovuar eficiencën e energjisë në sektorët e transportit dhe industrisë.

Mali i Zi: Zgjerimi dhe pasurimi i skemave të EE që nuk janë të detyrueshme mund të forcojë përpjekjet e Malit të Zi për eficiencën e energjisë. Planet e veprimit të përshtatura enkas për sektorët e industrisë dhe transportit, diversifikimi i financimit për projektet e EE dhe promovimi i ndërgjegjësimit publik janë hapa me rëndësi jetike. Forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit dhe lehtësimit i partneritetit publik-privat do të kontribuojë gjithashtu në implementimin efektiv të EE.

Maqedonia e Veriut: Dhënia prioritet zhvillimit të skemave të eficiencës së energjisë për Fondin e Eficiencës së Energjisë dhe krijimi i mekanizmave monitorues për ndërtesat e reja janë thelbësore në Maqedoninë e Veriut. Përmirësimet legjislative do të duhej të trajtohen me prioritet, së bashku me promovimin e iniciativave për eficiencën e energjisë në sektorët e transportit dhe industrisë.

Serbia: Azhurnimi i legjislacionit kombëtar për t'u përafuar me standardet e Komunitetit të Energjisë dhe përmirësimi i programeve kombëtare me qëllim nxitjen e investimeve në masat e eficiencës së energjisë janë prioritetet kryesore në Serbi. Krijimi i fondit qarkullues të dedikuar për financimin e masave të EE brenda sektorit industrial do të ofronte mundësi financimi të qasshme për bizneset. Duke lehtësuar qasjen në kapital, Serbia mund të përshpejtojë adoptimin e praktikave me eficiencë të energjisë në të gjithë sektorët.

